

RP _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE E INFRASTRUKTURËS

PLAN VEPRIMI I SHKURTUAR PËR SHPRONËSIM

(I përditësuar)

PROJEKTI SHQIPTAR I INVESTIMIT
NË SEKTORIN E UJIT

Përgatitur nga:
QENDRA SHQIPTARE PËR KËRKIME EKONOMIKE
Rruga "I. Qemali", Nr 1 Tiranë – Shqipëri
Telefon: +355 42 274603 Fax: +355 42 274603
E-mail: zef.preci@gmail.com

(Numri i raportit: Kontrata CSD4 PHRD Granti Nr. Tf093096-AI)



QSHKE

Shkurtime

BB	Banka Botërore
DRN	Rrjeti i Studiuësve për Zhvillim
NjZPU	Njësia e Zbatimit të Projektit të Ujit
NjPM	Njësi e Pavarur Monitorimi
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
QShKE	Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike
PNP	Persona të Ndikuar nga Projekti
RAP	Plani i Veprimit për Rivendosje
RPF	Kuadri i Politikave të Rivendosjes
VS	Vlerësimi Social
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhje	4
1. Census mbi personat e prekur dhe vlerësimi i aktiveve.....	5
1.1. Data e vlerësimit (Cutt off date) për projektin	5
1.2. Përzgjedhja	5
1.3. Vlerësimi Socio-Ekonomik	5
1.4. Përdorimi i Tokës/Zonës së Prekur	7
1.5. Pronësia e PNP-ve	8
2. Përshkrimi i shpërblimit dhe asistenca të tjera për shpronësimin.....	11
2.1. Aktiviteti i Kompensimit	11
2.1.1. Kriteret Ligjore në Vlerësimin e Pronësisë	12
2.2. Kriteret e Bankës Botërore në Vlerësimin e Pronësisë	13
2.3. Shpërblimi për Përdorimet e Tokës së Zonave të Mbrojtëse	14
2.3.1. Të Dhëna të Përgjithshme mbi Zonat e Mbrojtjes	14
2.3.2. Kufizime të lidhura me Zonën e Puseve	15
2.4. Kompensimi Financiar	17
2.5. Vlerësimi i Kompensimit të Plotë	17
2.5.1. Përmbledhja e alternativave të pranueshme dhe mundësitë e kompensimit	17
2.5.2. Të dhëna mbi mundësitë e pranueshme, metodologjinë dhe kompensimin e PNP-ve	19
3. Konsultime me personat e prekur nga projekti (PNP) mbi mundësitë e pranueshme	23
3.1. Objektivat e konsultimeve dhe e informimit publik	23
3.2. Procesi i Informimit Publik	23
4. Përgjegjësitë Institucionale për Zbatimin, Ankimin dhe Kompensimin.....	24
4.1. Përgjegjësitë institucionale për zbatimin e projektit	24
4.2. Procedurat për ankimim	28
5. Monitorim dhe Vlerësim	29
5.1. Monitorimi i Brendshëm	29
5.2. Monitorimi i Jashtëm dhe Vlerësimi	29
6. Afatet dhe buxheti.....	31
Aneks 1. Informacione për Llogaritjen e Çmimit të Rekomanduar.....	32
Aneks 2. Akt-Marrëveshje Tip midis Njësive të Qeverisjes Vendore dhe PNP-ve.....	34
Aneks 3. Harta e Zonës së Puseve	42
Aneks 4 A. Skicat e dorës së Zonës së Puseve	43
Aneks 4 B. Stacionet e Pompimit, Fushë Kuqe	45

Lista e Tabelave

Tabela 1. Pronësia e prekur sipas njësive ekonomike familjare dhe rezidentëve	6
Tabela 2. Përdorimi Bujqësor i Tokës	8
Tabela 3. Të dhëna mbi pronësitë e PNP-ve dhe inventarin e aktiveve të tyre	9
Tabela 4. Matrica e të Drejtave të Pronësisë	12
Tabela 5. Kompensimi i llojeve të pronave	18
Tabela 6. Pasqyra për llogaritjen e çmimit për shpronësimet e tokës bujqësore	19
Tabela 7. Pasqyra e të dhënave të kompensimit	21
Tabela 8. Rregullimet Institucionale për Zbatim	25

Pasqyra 1. Lista zyrtare e shpronësimeve nga ndërtimi i korridorit Durrës-Morinë (seksioni Milot-Rrëshen; fshatrat: Fushe milot, mal i bardhe)	32
Pasqyra 2. Harta e Vlerave të Shpronësimit Rrethi Kurbin sipas VKM (2014)	33

Përmbledhje

Plani i Veprimit për Shpronësim është përgatitur duke u mbështetur ne politikat operacionale të Bankës Botërore (OP 4.12: Mbi Zhvendosjen e Pavullnetshme), dokumenteve teknike të Projektit Shqiptar në Sektorin e Ujit dhe kuadrit ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Zbatimi i Projektit Shqiptar në Sektorin e Ujit për ndërtimin e ujësjellësit të Durrësit prek komunitetet në Qarkun e Lezhës dhe në Qarkun e Durrësit, ku i pari përfshin Njësitë Milot dhe i dyti Njësinë Ishëm dhe Sukth.

Për të minimizuar efektet e shpronësimit nga ndërtimi i sistemit të ri të furnizimit me ujë të pijshëm që do të mundësohet nga zbatimi i projektit, janë shmangur sa ka qenë e mundur tokat private të zëna me ndërtesa banimi dhe/ose ndërtesa biznesi. Kuadri ligjor në fuqi për zbatimin e projektit parashikon që personat e ndikuar nga projekti (PNP) të kompensohen për çdo humbje të aseteve fizike, të të ardhurave dhe fitimeve që rrjedhin nga kryerja e këtij investimi, pavarësisht nëse këto humbje janë të përkohshme apo të përhershme. Megjithatë, vrojtimi (Census-i) ka treguar se ndërtimi i sistemit të ri të furnizimit me ujë prek kryesisht vetëm tokat bujqësore, bimësinë dhe prodhimin në këto toka.

Zbatimi i projektit do të ndikojë drejtpërdrejt mbi PNP-të, sepse ata do të shpronësohen për një hapësirë të caktuar të pronës së tyre. Shpronësimi kryhet për interes publik dhe toka bujqësore e marrë do të përdoret për ndërtimin dhe funksionimin e Sistemit të Ujësijellësit të Durrësit. Projekti do të ndikojë pozitivisht në mënyrë të tërthortë edhe komunitete të tjera (fshatrat) nëpër tokat e të cilëve kalon tubacioni aktual i ujit, nëse do të vendoset që ky tubacion të shërbejë në të ardhmen për furnizimin me ujë të këtyre zonave (furnizimi aktual i tyre bëhet vetëm disa orë në ditë).

Vlerësimi i kryer gjatë përgatitjes së RAP tregon se pjesa tjetër e tokës, përveç asaj së shpronësuar, është ende e përdorshme ekonomikisht, dmth PNP-të dëmtohen në një sipërfaqe të vogël të parcelës individuale së zotëruar prej tyre. Ja përse, niveli i të ardhurave të PNP-ve nuk përkeqësohet edhe mbas pas zbatimit të projektit, por mund të përmirësohet nga kompensimi financiar i pjesës së tokave të shpronësuar. Vëzhgimet në terren dhe të dhënat e mbledhura gjatë përgatitjes së RAP tregojnë se pronarët e tokës bujqësore e përdorin për kultivimin e produkteve bujqësore dhe të bimëve drufutore. Zbatimi i këtij RAP nuk parashikon/kërkon ndihma për rehabilitimin dhe/ose ndihma për të zhvendosur shtëpi dhe/ose ndërtesa të tjera biznesi të prekura, por vetëm kompensim në të holla për parcelat e tokës bujqësore të shpronësuar. RAP gjithashtu parashikon që PNP-ve t'iu ofrohet asistencë nga komiteti i ankimeve për njohjen dhe respektimin e të drejtave ligjore dhe kushtetuese të tyre.

Mënyra e kompensimit e vlefshme për këtë procedurë shpronësimi sipas legjislacionit shqiptar në fuqi është kompensimi financiar, në të holla. Ky kompensim është plotësisht i mjaftueshëm për të dëmshpërblyer tokën bujqësore të shpronësuar. Të gjithë PNP-të kanë pranuar mënyrën e kompensimit financiar (në të holla) për shpronësimin e tokës së tyre për interes publik. Kostoja totale për kompensimin e shpronësimeve është vlerësuar paraprakisht 7741082.3 ALL, e vlefshme për një sipërfaqe totale 6393.8 m² dhe një sërë kulturash bujqësore dhe pemësh të prekura nga shpronësimi.

1. Census mbi personat e prekur dhe vlerësimi i aktiveve

Plani i Veprimit për Shpronësim (RAP) është përgatitur duke u mbështetur në kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë mbi shpronësimet për nevoja publike dhe në dokumentet e punës të Bankës Botërore mbi Zhvendosjen e Pavullneshme (OP 4.12).

Objektivat kryesorë të këtij RAP të shkurtuar janë:

1. Të zbusë ndikimet negative që lidhen me vend-ndodhjen e burimeve (puseve) dhe tubacionit të transmetimit të ujit;
2. Të bëjë të mundur që PNP-të të jenë në dijeni të plotë të të drejtave të tyre;
3. Të maksimizojë përfshirjen e PNP-ve dhe të komunitetit në të gjitha fazat e zbatimit të Planit të Veprimit për Shpronësim (RAP);
4. Të sigurohet që niveli i jetesës së PNP-ve do të përmirësohet ose të paktën nuk do të përkeqësohet si pasojë e afërsisë me vend-burimet e ujit të pijshëm dhe tubacioneve të transmetimit të tij.

Për hartimin e këtij raporti janë ndërmarrë një sërë aktivitete të përgjatë periudhave të ndryshme të punës. Disa prej tyre janë si më poshtë:

- Grumbullim i informacionit social-ekonomik duke u bazuar në popullatën e prekur;
- Identifikimi i numri të familjeve dhe përbërjes së tyre, të prekura nga ndërtimi i ujësjellësit;
- Identifikimi i tokës dhe aseteve të tjera eventuale të mundshme për t'u shpronësuar gjatë zbatimit;
- Përcaktimi i aktiveve (tokës dhe aseteve të tjera specifike) për t'u shpronësuar gjatë zbatimit të projektit për ndërtimin e ujësjellësit;
- Përcaktimi i kostove financiare të shpronësimit për çdo aset që do të shpronësohet.

1.1. Data e vlerësimit (Cutt off date) për projektin

Për qëllim të përcaktimit të pronësive të PNP-ve, data e vlerësimit të projektit përcaktohet data e kryerjes së Census-it dhe studimit social të familjeve të prekura. Për këtë projekt, kjo datë përkon me përfundimin e kryerjes së census-it të projektit (31.03.2013)

1.2. Përzgjedhja

Në listën e PNP-ve janë përfshirë familjet/individët të cilët në datën e vlerësimit të projektit (cutt of date) kanë qenë rezidentë, kanë përfituar të ardhura nga toka bujqësore ose trualli në zonat e prekura dhe të cilët për shkak të zbatimit të projektit do të humbasin pjesë të caktuara të tokës bujqësore, të mbjellave, godinave, të ardhurave financiare, etj.

1.3. Vlerësimi Socio-Ekonomik

Siç u sqarua më sipër, komunitetet e prekura nga përvetësimi i tokës sipas projektit janë të vendosura në bashkitë e Kurbinit (në njësinë Milot dhe Fushë Kuqe), si dhe të Durrësit (njësia administrative e Ishmit dhe ajo e Sukthit). Familjet që banojnë në afërsitë e linjës së tubacionit të propozuar të ujit në projekt dhe përreth nuk do të ndikohen në mënyrë të drejtperdrejtë nga ndërtimi i puseve dhe tubacionit të ri të ujësjellësit. Në rastet kur ka qenë e pamundur shmangia e shpronësimit të tokës bujqësore, pronarët do të shpërblehen për tokën e shpronësuar. Projekti do të ndikojë drejtpërdrejt mbi PNP-të, të cilët do të shpronësohen për një sipërfaqe të caktuar të pronës së tyre, e nevojshme për ndërtimin dhe funksionimin e

Sistemit të Ujësllësit të Durrësit. Projekti do të prekë në mënyrë të tërthortë edhe komunitetet e tjera (fshatrat), përmes të cilëve kalon tubacioni aktual i ujit. Nëse do të vendoset, ky tubacion do të shërbejë në të ardhmen për sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm, furnizim i cili aktualisht është i mundur vetëm disa orë në ditë.

Nga të dhënat e grumbulluara gjatë përgatitjes së RAP, vihet re se pjesa tjetër e tokës bujqësore, përtej asaj së shpronësuar, është ende e përdorshme ekonomikisht. Në këtë mënyrë, niveli i të ardhurave të PNP-ve nuk përkeqësohet pas projektit, por mendohet se mund të përmirësohet nga të hollat shtesë nga kompensimi i sipërfaqes së tokave që do të shpronësohen. Ky konkluzion mbështetet në faktin se vlera e kompensimit të sygjeruar për shpronësimin e pjesëve të parcelave të tokës bujqësore të nevojshme për ndërtimin e puseve të ujit dhe tubacioneve të ujësllësit është e krahasueshme me vlerën për njësi të tokave bujqësore që kanë qenë subjekt i shitblerjes në zonën në fjalë gjatë katër-pesë viteve të fundit. Dmth kompensimi financiar i rekomanduar në RAP, iu mundëson PNP-ve për të investuar në blerjen e një toke në kushte të përafërta të prodhimitarisë bujqësore brenda njësive administrative ose në afërsi të saj. Duke qenë se që të gjithë pronarët (që përfaqësojnë njësitë familjare të ndikuara) zotërojnë edhe parcela të tjera përveç asaj që preket nga zbatimi i projektit në të njëjtën njësi (tokë bujqësore, pemtore, tokë truall, etj.) kjo redukton në masë të ndjeshme shkallën e prekshmërisë së nivelit të tyre të jetesës. Shkalla e kompensimit është vlerësuar e mjaftueshme për të mbuluar nevojat e PNP-ve për sipërfaqen e tokës bujqësore që do të shpronësohet, ndonëse zona në fjalë karakterizohet nga një nivel i lartë i papunësisë, vartësi e dukshme nga të ardhurat nga emigracioni ekonomik jashtë vendit dhe mundësi të kufizuara për sigurimin e të ardhurave nga veprimtaritë jobujqësore.

Tabela 1. Pronësia e prekur sipas njësive ekonomike familjare dhe rezidentëve

Nr	Njësiti Administrative	Sip m2	Nr i njësive ekonomike	Nr total rezidentësh
1	Njësia Milot	3750	9	42
2	Njësia Fushëkuqe	437.5	3	13
3	Njësia Ishem	1850	18	90
4	Njësai Sukth	350	1	7
Total	4	6393.8	41	152

Census-i në shkallë të vogël (me shembull të vogël) përfshin grumbullimin e të dhënave socio-ekonomike dhe takime e diskutime me zyrtarët vendorë dhe komunitetin e fshatrave të ndikuara nga ndërtimi i tubacionit të ujësllësit. Informacioni i grumbulluar përfshin: aksesin në prona, të dhëna bazë demografike; të dhëna mbi burimin e të ardhurave, të dhëna mbi veprimtaritë bujqësore/blegtorale, veprimtarinë kryesore ekonomike, shkallën e papunësisë dhe emigracionit, etj. Kështu nga censusi rezulton se numri i parcelave të prekura është 34, numri i pronësive është 32 dhe se PNP-të përfaqësojnë 41 njësi ekonomike familjare (households) me një total prej 152 anëtarësh. Në aspektin socio-ekonomik, rreth 68% janë në moshë pune, 34% të papunë të deklaruar dhe në kërkim të mundësive për punësim, 20% të vetëpunësuar në biznesin e familjes apo të punësuar me kohë të pjesshme, në administratën vendore, etj., dhe 10% janë nxënës dhe studentë. Niveli më i lartë i papunësisë vihet re në Njësinë Milot, ndonëse një numër i PNP-ve dhe anëtarëve të familjeve së tyre janë larguar në fshatra të tjera brenda njësisë ose kanë shkuar në emigracion jashtë vendit.

Megjithatë, vlerësimi socio-ekonomik për qëllimet e këtij projekti tregon se statusi ekonomik i PNP-

ve nuk do të përkeqësohet në krahasim me gjendjen përpara projektit si pasojë e përvetësimit të tokës. Kjo theksohet duke pasur parasysh se toka bujqësore e mbetur pas shpronësimit do të mund të përdoret ekonomikisht për të kultivuar dhe për të zhvilluar veprimtari bujqësore si në përdorimin aktual sipas kufizimeve të këtij RAP-i. Në pjesën e puseve të ujit të pijshëm, sipas vlerësimit inxhinierik, për zbatimin e projektit nevojitet një pjesë e vogël e tokës. Asnjërit prej pronarëve të tokës nuk do t'i përvetësohet tërësisht e gjithë sipërfaqja e tokës bujqësore që gjendet aktualisht në zotërim familjar nga secili prej tyre.

Gjithashtu nga të dhënat e Census-it, rezultojnë se të gjithë PNP-të zotërojnë në pronësi së paku nga një ngastër tjetër të tokës bujqësore në të njëjtën zonë ose në zonat përreth dhe se bujqësia në shumicën e rasteve nuk është burimi i tyre i vetëm/kryesor i të ardhurave, apo për mbijetesën e tyre ekonomike. Kjo duke marrë parasysh se produktet e tokës bujqësore përdoren kryesisht për konsum familjar dhe një pjesë fare e vogël e tyre për tregun vendas. Prandaj, mbi bazën e arsytimit të mësipërm dhe të dhënave social-ekonomike të grumbulluara në terren, mund të arrihet në përfundimin se pjesa e shpronësuar me kompensim nuk ndikon burimin e të ardhurave të asnjë prej PNP-ve.

Në lidhje me grupet e marginalizuara, të tillë si: personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, të moshuarit, gra kryefamiljare, të cilët janë zakonisht më të prekur në situata të tilla, nuk ka asnjë dëshmi se statusi i tyre do të përkeqësohet si rezultat i zbatimit të projektit.

1.4. Përdorimi i Tokës/Zonës së Prekur

Për të minimizuar efektet e shpronësimit nga ndërtimi i puseve dhe tubacionit të ri të ujit të pijshëm që do të mundësohet nga zbatimi i projektit, janë shmangur sa ka qenë e mundur tokat private të zëna me ndërtesa banimi ose/edhe ndërtesa biznesi. Kjo u konfirmua edhe nëpërmjet vëzhgimit në terren në kuadër të përgatitjes së RAP, i cili tregon se vend-burimet e puseve dhe tubacioni i planifikuar i ujit në shumicën e gjatësisë së tij kalon përgjatë rrugës ekzistuese (në të djathtë të rrugës) dhe rrugëve që lidhin fshatrat, si dhe në kullota dhe lugina që janë pronë e subjekteve publike, të tilla si tokat bujqësore, pyjet dhe kullotat komunale. Komuna e mëparshme e Ishmit ka dhënë miratimin e saj për të përdorur tokën komunale për ndërtimin e tubacionit të ujit siç është planifikuar në gjurmën fillestare dhe projektin e zbatimit. Kjo përbëhet nga një sipërfaqe e vogël kullosore dhe pyjesh të vegjël kodrinore, e cila do jetë e papërdorshme përgjatë fazës së ndërtimit të projektit.

Toka e nevojshme për vend-burimin dhe tubacionet e ujit është e regjistruar si "*tokë bujqësore*" në dy njësi administrative sipas legjislacionit në fuqi nga data 23 Qershor 2015. (Nga zonat e prekura, Njësia Milot dhe ajo Fushë-Kuqe përfshihet në Bashkinë e Kurbinit, ndërkohë që Njësia Ishëm dhe ajo Sukth në Bashkinë e Durrësit.)

Vëzhgimet në terren dhe të dhënat e mbledhura përmes RAP tregojnë se të gjithë pronarët e tokës e përdorin tokën si kullotë, për kultivimin e produkteve bujqësore dhe të drufutorëve. Në sipërfaqen që do të shpronësohet nuk ka banesa, ndonjë strukturë tjetër ose struktura të tjera për tu shpronësuar.

Duke pasur parasysh rëndësinë e zonës së puseve, kufizimet e përshkruara më poshtë në këtë dokument në lidhje me aksesin dhe destinacionin e mundshëm të përdorimit jo vetëm të tokës që shpronësohet, por edhe të sipërfaqeve përreth kësaj zone, më poshtë jepet një listë me të mbjellat bujqësore dhe kulturat drufutore aktuale. (Për një paraqitje më të qartë të kësaj zonë shikoni hartën në Ankes. 3.)

Tabela 2. Përdorimi Bujqësor i Tokës

Pusi	Përdorimi Aktual i Tokës
FM E	Jonxhë
FM A	Grurë
FM 1	Pemë Kumbulle, Hardhi, Ulli, Shegë
FM D	Ullinj, Hardhi
FM 4	Pemë Qershie, Jonxhë
FM B	Misër

Sikurse është theksuar edhe më lart, zbatimi i këtij RAP-i nuk parashikon/kërkon ndihma për rehabilitimin dhe/ose ndihma për të zhvendosur shtëpi dhe/ose struktura të tjera të prekura, por vetëm kompensim në të holla për parcelat e tokës bujqësore të shpronësuar. RAP gjithashtu parashikon që PNP-ve t'iu ofrohet asistencë nga komiteti i ankimimeve.

1.5. Pronësia e PNP-ve

Në tabelë janë paraqitur të dhënat e marra nga Census-i i lidhur me tokat dhe aktivet e tjera të cilat përfaqësojnë pronësinë e PNP-ve. Të gjitha sipërfaqet e prekura të zotëruara në mënyrë private rezultojnë si tokë bujqësore, të përdorura për rritjen e kulturave bujqësore për përdorim familjar dhe rrallë për përdorim tregtar ose të lëna djerrë. Si referencë për hapësirën e tokës që do të shpronësohet, për çdo pronar në zonën e puseve janë përdorur skicat e dorës të përgatitura në kuadër të projektit dhe të Raportit Hidrogeologjik nga Prof. R. Eftimi (Shih Aneks 4 A. të këtij raporti).

Vizitat në terren treguan se pronarët përgjithësisht zotërojnë të paktën edhe një tjetër parcelë të tokës bujqësore dhe se jo më tepër se 20% e tokës po merret nga PNP-të dhe mund të theksohet se pjesa e mbetur e parcelës ku po bëhet shpronësimi është ekonomikisht e përdorshme. Nga intervistimi i PNP-ve rezulton se vetëm në një rast kjo sipërfaqe është pak më e madhe¹. Në këto rrethana mund të arrihet në përfundimin se shpronësimi nuk i përkeqëson kushtet ekonomike as për këtë pronar toke që do të shpronësohet pjesërisht.

Në momentin e hartimit të këtij raporti, vetëm 5 nga PNP-të e identifikuar janë ende në proces regjistrimi të pronësisë dhe vetëm 1 rast mbetet të jetë tërësisht i përgjigjshëm. Toka aktualisht në përdorim të tij për jetesë dhe përdorim tjetër figuron në kadastër si tokë në pronësi të ish-ndërmarrjes shtetërore që ka administruar burimet e vjetra të ujit të pijshëm², por familja që zotëron këtë sipërfaqe zotëron dokumentin mbi bazën e të cilit e ka përfitur, në zbatim të Ligjit Nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën".

Tre pronarët në Fushë Kuqe nuk kanë përfunduar ende procesin e regjistrimit të tokës së tyre, por ata gjithashtu e përdorin për jetesë dhe për përdorime të tjera në zbatim të Ligjit Nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën".

¹ Murat Veseli, Zona e Puseve

² Në dokumentet zyrtare të lëshuara nga ZVRPP Kurbin figuron si "tokë në pronësi shtetërore"

Tabela 3. Të dhëna mbi pronësitë e PNP-ve dhe inventarin e aktiveve të tyre

Nr	Komuna / Fshati	Emër Mbiemër i Pronarit	Nr. i Parcelës	Nr. Pronare	Lloji i Tokës	Sipërfaqe Totale (m2)	Toke e shpronësuar (%)	Vlerësimi i Bimësisë	Statusi Ligjor në ZRPP
1		Tokë/Pronë Shtet (Danjel Marku, i biri i Kol Marku sipas ligjit 7501)	35/27	1	Tokë Bujqësore	5000	625.0	1 Pemë Qershie, Jonxhë	Paregjistruar
2		Ndue Lazer Mhilli (Mark Mhilli, i biri. Pronësia e paregjistruar në emër të tij ende)	40/14	1	Tokë Bujqësore	7750	625.0	Grurë	Në proces
3	Milot / Fushë Milot	Loro Gjon Kolaj	38/17	1	Tokë Bujqësore	4000	625.0	Pemë Kumbulle, Hardhi, Ullinj, Shëgë	Regjistruar
4		Ismet Taf Veseli	43/2	1	Tokë Bujqësore	18000	312.5	Misër	Regjistruar
5		Xhumaille Adbulla Veseli	43/44	1	Tokë Bujqësore	2016	312.5	Jonxhë	Regjistruar
6		Murat Hasan Veseli	42/26	1	Tokë Bujqësore	1850	625.0	Ullinj, Hardhi	Regjistruar
7		Dervish Zenel Haxhiu (Djemtë: Musa, Kujtim, Fatmir Haxhiu në proces regjistrimi të pasurisë)	43/19	1	Tokë Bujqësore	11100	625.0	E pambjellë	Në proces
8		Lec Marashi	*	1	Tokë Bujqësore	6500	250	Jonxhë	Në proces
9	Fushëkuqe /Adriatik	Nikolle Gjeci	*	1	Tokë Bujqësore	23000	100	E pambjellë	Në proces
10		Kanto Gjeci	*	3	Tokë Bujqësore	22500	187.5	Misër	Në proces
11		Tofik Lleshi	444/4	1	Tokë Bujqësore	2000	150.0	E pambjellë	Regjistruar
12		Besnik Bregu, Petrit Ruka	444/10	2	Tokë Bujqësore	2000	62.5	E pambjellë	Regjistruar
13		Artan Dyrmishi	444/11	1	Tokë Bujqësore	2002	68.8	E pambjellë	Regjistruar
14		Leonard Buda	444/6	1	Tokë Bujqësore	2000	143.8	E pambjellë	Regjistruar
15	Ishëm/Bize	Idri Metollari	444/14	1	Tokë Bujqësore	600	37.5	E pambjellë	Regjistruar
16		Tatjana Gjepali	444/15	1	Tokë Bujqësore	600	37.5	E pambjellë	Regjistruar
17		Shpresa Nasi	444/16	1	Tokë Bujqësore	600	37.5	E pambjellë	Regjistruar
18		Lulzim Kastrati	444/12	1	Tokë Bujqësore	1200	75.0	E pambjellë	Regjistruar
19		Drita Kuci	444/8	1	Tokë Bujqësore	500	50.0	E pambjellë	Regjistruar

PLAN VEPRIMI I SHKURTUAR PËR SHPRONËSIM

RAP

20	Selim Mita	445/8	1	Tokë Bujqësore	1250	62.5	5%	E pambjellë	Regjistruar
21	Mitat Hebibaj	445/11	1	Tokë Bujqësore	1000	62.5	6%	E pambjellë	Regjistruar
22	Ndue Jaku	445/30	1	Tokë Bujqësore	4000	93.8	2%	E pambjellë	Regjistruar
24	Hasan Selita, Etleva Selita	445/31	2	Tokë Bujqësore	2000	81.3	4%	E pambjellë	Regjistruar
23	Xhermal Bafti, Sherife Bafti, Mimoza Bafti, Nazir Bafti	445/32	4	Tokë Bujqësore	2500	81.3	3%	E pambjellë	Regjistruar
25	Edlira Hamataj	445/33		Tokë Bujqësore	2500	12.5	1%	E pambjellë	Regjistruar
		445/34	1	Tokë Bujqësore	2000	81.3	4%	E pambjellë	Regjistruar
		445/35		Tokë Bujqësore	4000	125.0	3%	E pambjellë	Regjistruar
26	Hariz Piluri, Violeta Piluri	445/36	2	Tokë Bujqësore	4000	125.0	3%	E pambjellë	Regjistruar
27	Luan Saraci, Fetah Kazia, Hamza Kazia, Baftjar Kazia, Qani Hyse, Gentian Meta	445/37	6	Tokë Bujqësore	4000	81.3	2%	E pambjellë	Regjistruar
28	Samir Gjepali	445/38	1	Tokë Bujqësore	2000	62.5	3%	E pambjellë	Regjistruar
29	Veli Kajmaku	445/53	1	Tokë Bujqësore	3000	37.5	1%	E pambjellë	Regjistruar
30	Shpresa Sofija	445/50	1	Tokë Bujqësore	3000	93.8	3%	E pambjellë	Regjistruar
31	Avni Fida	444/54	1	Tokë Bujqësore	1260	93.8	7%	E pambjellë	Regjistruar
32	Sukth/Hama Ilaj	58/11	1	Tokë Bujqësore	6840	350	5%	E pambjellë	Regjistruar

2. Përshkrimi i shpërblimit dhe asistencë të tjera për shpronësimin

2.1. Aktiviteti i Kompensimit

Mungesa e lejeve/titujve: Kur ndodh, shpronësimi mund të përfshijë humbjen e tokës, strehimit ose burimeve të të ardhurave. Siç tregohet në kriteret e kualifikimit për të marrë kompensim, këta do të përfshijnë ata pronarë të cilët e zotërojnë ose e përdorin tokën e prekur, por nuk disponojnë dokumentacionin që tregon të drejtat formale apo ligjore të njohura për tokën apo lejet për ndërtesat.

Humbja e të ardhurave: Nëse më pak se 10-20% e tokës së një individi ndikohet negativisht nga procesi i përvetësimit të tokës për një nën-projekt të veçantë – nuk pritet humbje e konsiderueshme e të ardhurave dhe ndikimet mund të konsiderohen në përgjithësi se janë të vogla. Në këto raste, kompensimi do të ofrohet si në tabelën e mëposhtme. Megjithatë, në qoftë se PNP-të vuajnë humbjen e të ardhurave nëpërmjet humbjes së më shumë se 20% të tokës, reduktimi i të ardhurave është i mundshëm dhe do të jepet ndihmë, nëse kërkohet. Kjo do të marrë formën e "Ndihmës së Rehabilitimit" që do të thotë ndihmë që përfshin punësimin, trajnim për punë, apo forma të tjera të mbështetjes për të mundësuar familjet e dëmtuara, të cilat kanë humbur burimin e mjeteve të tyre të jetesës për të përmirësuar ose të paktën për të kthyer nivelet e tyre të të ardhurave dhe nivelin e jetesës në kufinj të periudhës së para-projektit.

Humbja e Strukturave: Nuk pritet të ketë ndonjë strukturë rezidenciale që do të nevojitet për t'u shpronësuar në zonën e projektit. Megjithatë, në rast se ka struktura (plevica, kioska, ndërtesa të vogla tregtare, etj) që do të duhet të prishen, "amortizimi" nuk do të përdoret për llogaritjen e kompensimit që duhet paguar për strukturat e ndikuara dhe njerëzit e ndikuar do të jenë në gjendje për të zëvendësuar strukturat e tyre me shumën e kompensuar.

Humbja e pronave të komunës: Në raste të parcelave të cilat janë prona komunale, sipas legjislacionit shqiptar ato nuk shpronësohen, por me vendim të Këshillit të Ministrave transferohen pa shpërblim në pronësi të Shërbimit Publik, në rastin konkret të Ujësjellës Durrës. Situata ligjore është rregulluar me një sërë aktesh ligjore duke përfshirë ligjin nr. 10 119, datë 23. 4. 2009 "Për Planifikimin e Territorit".

Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se: objektivi kryesor i procesit të rivendosjes/shpronësimit është të sigurojë që të mos ndodhë asnjë ndryshim negativ në jetesën e personave të ndikuar dhe veprimtarisë së tyre përkatëse. Strategjitë synojnë promovimin e mjeteve të sigurimit të jetesës përmes stimuljeve të ndryshme ekonomike.

Tabela 4. Matrica e të Drejtave të Pronësisë

Kategoria e PNP		Lloji i humbjes			E drejta e pronësisë		
Pronarë të tokave private	Përkufizim		Lloji i ndikimit	Personi me titull pronësie	Kompensimi për humbjen e asetëve	Kompensimi për humbjen e strukturave	
	Të ndikuar direkt nga nevojat e projektit për tokë	Tokë bujqësore 6487.5 m ²	Humbja e asetëve fizike	Zotëruesi / mbajtësi i titullit	Kompensim në të holla për tokën e prekur i barazvlefshëm me vlerën e tregut/supozimet e pronës të mjaftueshme për të zëvendësuar asetet e humbura dhe për të mbuluar kostot e transaksionit.	6393750.0 ALL	Nuk pritet
		Humbja e të korrave dhe pemëve	Humbja e të korrave	Nga censusi: janë identifikuar disa pronarë.	Vlera e zëvendësimit të kulturave të përhershme të blera me koston e tregut jo në "sezonin" e tyre.	1181522.3 ALL	Nuk pritet, por në çdo rast, kompensimi do të bëhet me vlerë të plotë zëvendësimi të pa amortizuar.
			Humbje e pemëve produktive	Nga censusi: janë identifikuar disa pronarë.	Vlera e zëvendësimit e barazvlefshme me koston për blerjen për një pemë të re, të punës, dhe të humbjes së të ardhurave derisa pema të bëhet produktive	165810 ALL	Nuk pritet, por në çdo rast, kompensimi do të bëhet me vlerë të plotë zëvendësimi të pa amortizuar.
			Humbja e shtëpive, bizneseve ose strukturave	Shtëpi, biznes ose strukturë	Asnjë i identifikuar	Kompensimi në të holla në bazë të vlerësimit të ekspertëve për koston e zëvendësimit dhe materialeve	N/A
Përdorues Informal të tokës	A janë ata që nuk kanë asnjë titull ligjor mbi pronësinë e tokës (banorët që jetojnë në vend)	Humbja e vendbanimit ose vendit të biznesit	Humbje e strukturës	Nga censusi: nuk është identifikuar asnjë	Kompensimi në të holla në vlerë të plotë zëvendësimi për strukturën (por jo për tokën)	N/A	Nuk pritet, ndihma duke u zhvendosur në një vend tjetër

1.1. Kriteret Ligjore në Vlerësimin e Pronësisë

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 138, datë 23.3.2000, parashikon kriteret ligjore për vlerësimin e pronave të prekura nga shpronësimi.

- **Toka:** Vlerësimi i tokës së shpronësuar do të përcaktohet për tokat urbane, tokat brenda vijës së verdhë të qytetit dhe pronat në njësitë vendore sipas çmimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave që rrjedhin nga Ligji Nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave private" (Shih hartën e çmimeve).

- **Pronat rezidenciale:** Vlera e kompensimit të shpronësimit për **pronat rezidenciale** (banesat) konsiderohet çmimi mesatar i shitjes, sipas të dhënave të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP).
- **Pronat industriale dhe bujqësore:** Vlera e kompensimit të shpronësimit për pronat industriale dhe bujqësore konsiderohet çmimi mesatar i shitjes, sipas të dhënave të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, ose Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Amortizimi i pasurisë duhet të zbritet nga çmimi.
- **Toka bujqësore, zonat pyjore, etj:** Vlera e vlerësimit të tokave bujqësore, zonave pyjore dhe kullotave është përcaktuar nga çmimet e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave private". Në rastet ku nuk ka çmime të miratuara për rajone të caktuara, vlerësimi për tokat bujqësore, zonat pyjore dhe kullotat përcaktohet nga çmimi mesatar i shitjes i vënë në dispozicion nga ZRPP.
- **Pemët frutore:** Për pemët frutore vlera e parashikuar është llogaritur duke marrë parasysh kostot e investimeve dhe shpenzimet. Kjo vlerë është përlogaritur për njësi (numri i pemëve frutore) ose njësi për sipërfaqen e tokës (m² vreshtat etj.). Investimi i pranishëm në tokë, shpenzimet totale dhe faktorë të ndryshëm të amortizimit janë parashikuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.
- **Të korrat:** Për të korrat, vlera është përlogaritur në bazë të rendimentit që pritet dhe të çmimit të tregut për njësi.

Pavarësisht parashikimeve ligjore të mësipërme, mbështetur në Nenin 2 të Ligjit Nr.10428, datë 06.02.2011, "Për të drejtën ndërkombëtare private" çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi dispozitat e këtij ligji, kur dispozitat e tij nuk pajtohen me të. Kjo do të thotë se, në rast të ndonjë hapësire apo mospërputhje e ligjit shqiptar dhe politikave të Bankës Botërore, marrëveshja ndërkombëtare mes tyre mbizotëron kuadrin legjislativ të shtetit shqiptar; e njohur gjithashtu si epërsi e marrëveshjeve ndërkombëtare.

2.2. Kriteret e Bankës Botërore në Vlerësimin e Pronësisë

Politikat e Bankës Botërore kërkojnë zbatimin e legjislacionit vendas për vlerësimin dhe kompensimin e humbjeve për aq kohë sa përmes këtij zbatimi bëhet e mundur që të respektohen parimet e sanksionuara në dokumentet e saj zyrtare. Në këtë proces, themelore mbetet që kompensimi financiar të sigurojë zëvendësimin e aktiveve të humbura. Kompensimi duhet të bëhet i plotë për aktivet të cilat preken në mënyrë të drejtpërdrejt nga projekti. Kështu, në dokumentin mbi Politikën Operacionale për Zhvendosjen e Pavullnetshme (OP 4.12) thuhet shprehimisht:

"Lidhur me tokën dhe strukturat, "kostoja e zëvendësimit" përkufizohet si vijon: Për tokën bujqësore, është vlera e tregut të tokës me kapacitet të njëjtë prodhimi ose përdorimi e vendosur në afërsi të tokës së prekur, përpara zbatimit të projektit ose përpara zhvendosjes (më e larta mes tyre), plus kostot e përgatitjes së tokës për ta sjellë në kushtet e tokës së prekur, plus kostot e çdo regjistrimi apo takse. Për shtëpitë dhe strukturat tjera, është vlera e tregut të materialeve që kërkohen për të ndërtuar strukturën e prekur ose për të rregulluar strukturat e prekura pjesërisht, plus kostot e transportit të materialeve në vendin e ndërtimit, plus kostot e punës dhe të çdo takse apo regjistrimi. Në përcaktimin e kostove të zëvendësimit, zhvlerësimi i aktiveve të materialeve nuk merret parasysh dhe as vlera e përfitimit nga projekti nuk i zbritet vlerës së aktivitetit."

Në Politikën Operacionale të Bankës Botërore gjithashtu është përcaktuar se nëse legjislacioni vendas nuk arrin standardin e kompensimit të përcaktuar nga Banka Botërore, dmth në kosto të plota të zëvendësimit, kompensimi sipas legjislacionit vendas duhet të plotësohet me masa shtesë në mënyrë që të

arrije standardin e përcaktuar. Nëse në kuadër të hartimit të këtij RAP janë marrë masa shtesë, ato janë përmendur dhe shpjeguar qartazi në RAP.

2.3. Shpërblimi për Përdorimet e Tokës së Zonave të Mbrojtëse

2.3.1. Të Dhëna të Përgjithshme mbi Zonat e Mbrojtjes

Në realizimin e vlerësimit të impaktit të mundshëm social nga ndërtimi i sistemit të furnizimit me ujë të Durrësit, u identifikuan tre specifika të rëndësishme për qëllime të planifikimit, të vlerësimit dhe mbrojtjes:

- i) Puset duhet të mbrohen nga ndotja e drejtpërdrejtë në afërsi të pusit;
- ii) Uji i pusit duhet të mbrohet nga kontaminimi mikrobiologjik, dhe
- iii) Uji i pusit duhet të mbrohet nga ndotja kimike.

Ja përse, tre zona të rëndësishme u përcaktuan sipas ndikimeve të pritura që mund të vijnë në cilësinë e jetës së popullatës vendase nga ndërtimi i ofruesit të ri të ujit:

a) Zona e Rreptësisë së Mbrojtjes Sanitare (e identifikuar nga raporti hidrogeologjik si zona S1) ka për qëllim mbrojtjen e burimit të ujit nga ndotjet e menjëhershme, për rrjedhojë sipërfaqet e përcaktuara të kësaj zone janë subjekt i shpronësimit të tokës bujqësore dhe aseteve të tjera të patundshme.

b) Zona e Afërt e Mbrojtjes Sanitare³ përfshin mbrojtjen e pellgut ujëmbajtës në një rreze prej 150 m nga vendburimi i pusit të ujit. Ajo gjendet në vendbanimet dhe tokat në kontakt me zonën e puseve. (E identifikuar nga raporti hidrogeologjik si zona S2).

c) Zona e Largët e Mbrojtjes Sanitare⁴, e cila njihet ndryshe edhe si “brezi i mbikqyrjes epidemiologjike”, në të cilën vendoset kontrolli shëndetësor dhe epidemiologjik edhe mbi popullsinë që banon në zonë, e ndikuar nga masat kufizuese/zbutëse për parandalimin e ndotjes së ujit, të cilat duhet të monitorohen me qëllim përdorimin pas ndërtimit të sistemit të ri të furnizimit me ujë.

Për të ruajtur cilësinë e ujit në burim, në legjislacionin shqiptar gjithashtu përcaktohet zona e mbrojtjes sanitare të sipërfaqes së basenit uJOR. Kufijtë e këtyre zonave dhe rregullat përkatëse janë të përcaktuara në detyrimet e Ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996, “Për rezervat ujore” dhe në Rregulloren Higjieno-Sanitare për ujin e pijshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.

Për parandalim të vazhdueshëm të çfarëdolloj mundësie ndotjeje të zonës së puseve, një numër i caktuar procesesh teknike mund të ndërmerren pranë zonës së puseve, duke mbajtur parasysh sygjerimet dhe udhëzimet e inxhinierëve hidro-gjeolog dhe të autoriteteve vendore të higjienës. Një kujdes i lartë i treguar për këto zona të mbrojtjes mund të përjashtojë mundësitë për ndotje të ujit që do të shërbejë si ujë i pijshëm në fazën e shfrytëzimit të projektit.

Sipas studimit hidro-gjeologjik⁵, “zona e rreptësisë” e njohur si S1 do të jetë rreptësisht e pakalueshme⁶. Kjo zonë përfshin zonën e puseve, depozitimin e ujit dhe stacionin/stacionet e pompimit. Përmasat rreth zonës së puseve të treguara edhe në skicat e dorës së Raportit të Zonës së Puseve të Raportit Hidrogeologjik, tregojnë se zonat e shpronësuara rreth puseve kanë forma të ndryshme gjeometrike. Specifikimet e bëra në këtë raport përcaktojnë një sipërfaqe 625m², e cila përputhet me përmasat e përcaktuara dhe mund të

³ Sipas terminologjisë shqip.

⁴ Sipas terminologjisë shqip.

⁵ Raport “Përmirësimi i Shërbimit të Ujësjellës-Kanalizimeve Durrës ‘ Projekti i Puseve të Rinj” Eftimi R., Qershor-Korrik 2015.

quhet e mjaftueshme si një zonë e parë kufizuese për ndotjen. Siç edhe është përcaktuar në të njëjtin raport, 10m⁷ distancë nga burimi do të jetë e mbuluar me cement, siç është përcaktuar në projekt.

Zona e dytë mbrojtëse e emërtuar si "S2" përfshin mbrojtjen e basenit në një distancë 150 m nga pusi. Siç u shpjegua më sipër në literaturë njihet edhe një zonë tjetër sigurie - "S3", e cila ndodhet mbi basenin ujqor në një distancë 1500m nga burimi. Kjo zonë njihet edhe si zona e mbrojtjes epidemiologjike në të cilën vendoset një kontroll shëndetësor dhe epidemiologjik mbi popullatën e zonës. Rregullat kryesore të zonës S2 zbatohen edhe në këtë zonë sigurie. Çdo ndërtim që do të bëhet në këtë zonë duhet detyrimisht të kërkojë autorizimin e duhur nga autoritetet përkatëse vendore, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) ose nga çdo institucion publik të autorizuar duke përfshirë një oponencë teknike zyrtare të një eksperti të hidro-gjeologjisë.

Duke marrë parasysh problematikën e trashëguar të ndërtimeve të paligjshme, si dhe shfrytëzimin e paligjshëm të ujit të pijshëm përmes puseve familjare, do të jetë e nevojshme që shfrytëzimi i ujit në këtë mënyrë (me puse individuale) të konsiderohet si dukuri provizore. Krahas ecures së ndërtimit të ujësjellësit, rekomandohet që Qeveria shqiptare dhe autoritetet vendore të marrin masa për sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe ujit për ujitjen e tokave bujqësore të zonës ku gjenden pusët përmes një rrjeti të ri të shpërndarjes së ujit në këtë komunitet. Kryerja e këtij investimi duhet shoqëruar me masat përkatëse për çmontimin e pompave individuale për nxjerrjen e ujit të pijshëm e nxjerrjes së ujit dhe të puseve përpara fillimit të shfrytëzimit të ujësjellësit të Durrësit, dmth përfundimit të punimeve për ndërtimin e ujësjellësit të Durrësit.

Punimet e ndërtimit dhe/ose ndërhyrjet për mirëmbajtje gjatë fazës së shfrytëzimit të ujësjellësit janë për t'u realizuar në toka të cilat janë pronë private. Nëse për arsye teknike do të zgjerohet aktiviteti i ujësjellësit në toka të tjera private, do të sigurohen rrugët hyrëse (servitutet) përkatëse në përputhje me projektin teknik të zbatimit të ndërtimit të ujësjellësit. Servitutet e zonës së puseve dhe të tubacioneve do të regjistrohen në Regjistrin Kadastral, në mënyrë që të sigurohet akses sa herë që nevojitet ndërtimi, funksionimi, mirëmbajtja dhe riparimi i puseve dhe tubacioneve që gjenden në toka bujqësore pronë private.

2.3.2. Kufizime të lidhura me Zonën e Puseve⁸⁹

1. S1-Zona e Rreptësisë së Mbrojtjes Sanitare

Në "zonën e rreptësisë" së mbrojtjes sanitare është i ndaluar çdo ndërtim me përjashtim të atyre në funksion të sistemit të ujit dhe mirëmbajtjes së tij si pusët e ujit, depozitimit të ujit dhe stacioni/stacionet e pompimit. Hyrja në këtë zonë duhet të pengohet me gardhe, të jetë e pajisur me tabela lajmëruese për moslejimin e kalimit dhe të jetë e mbrojtur nga çdo hyrje e paautorizuar. Duhet të ndalohet çdo veprimtari që nuk lidhet me transportin, trajtimin dhe akumulimin e ujit dhe të mirëmbajtjes së sipërfaqes së gjelbër, dhe bimësisë ose mbështetje teknike e zonës së ujit, çdo kablo nëntokësore ose tubacion që nuk lidhet me veprimtarinë e puseve.

Gjithashtu do të ndalohen ndërtimet e depove, depozitave të mbetjeve të çfarëdollojshme, përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve, hyrja dhe qëndrimi i kafshëve të punës apo të prodhimit, si dhe përdorimi i pajisjeve motorike. Të vetmet pajisjet motorike të lejueshme janë gjeneratorët e prodhimit të energjisë, nëse do të jetë e nevojshme. Asnjë kulturë bujqësore apo dru frutor nuk lejohet në këtë zonë dhe

⁷ Edhe kjo specifikë duhet të përcaktohet sipas vendndodhjes së pusit.

⁸ Bazuar në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", VKM NR.145, date 26.02.1998, "Për miratimin e rregullores Higjieno-Sanitare"

⁹ Të konsultuara edhe me Ekspertin Mjedisor të Projektit.

bari duhet të pritet dhe të hiqet rregullisht nga zona e mbrojtjes. Operatorët e shërbimit të ujit duhet të monitorojnë rregullisht parametrat fiziko-kimike dhe mikrobiologjike në të gjithë zonat e mbrojtjes.

Kjo është zona nga e cila PNP-të do të shpronësohen, ndërsa masa e kompensimit do të marrë në konsideratë pjesën e sipërfaqes së tokës që shpronësohet dhe të mbjellat që dëmtohen me këtë rast. Aty ku është e mundur, pa cënuar afatet e fillimit të punimeve në zonën e puseve, familjeve të parcelave që do të shpronësohen do t'u krijohet mundësia e grumbullimit të prodhimeve/të korrave në këtë zonë. Mbas përfundimit të procesit të shpronësimit, ata do t'a kenë të ndaluar hyrjen apo përdorimin e mëtejshëm të kësaj zone.

2. S2- Zona e Afërt e Mbrojtjes Sanitare

Në këtë zonë, veprimtaritë e vetme të cilat lejohen janë ato të bazuara në bujqësinë organike. Sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar dhe "praktikave më të mira" ndërkombëtare në zonën e afërt me burimet e ujit (zona S2) është i ndaluar ndërtimi i godinave ose përdorimi i tokës për veprimtari tregtare, nxjerrëse ose për veprimtari industriale. Gjithashtu, ky territor nuk mund të përdoret për ndërtim varrezash, për procese plehërimi, për depozitimin e mbeturinave, produkteve të naftës, mbeturinave kimike ose materialeve të tjera dekompozuese. Në këtë territor është e ndaluar prania e çfarëdolloj depozite të pesticideve dhe të plehrave kimike¹⁰. Përdorimi i pesticideve dhe kimikateve në zonë mund të bëhet përmes një autorizimi/leje nga institucionet përgjegjëse shtetërore¹¹ dhe përkundrejt njoftimit publik të përfituesve.

Zona duhet të jetë subjekt i vazhdueshëm i monitorimit për respektimin rigoroz të rregullave sanitare dhe në rast të sëmundjeve ngjitëse duhet të merren masa të forta anti-epidemiologjike. Aktualisht zona e puseve duhet të jetë e pastër me pak ndërtesa në zonën S2. Brenda këtij rripi nuk do të pranohen ndërtime të mëtejshme. Rindërtimi i kanaleve kulluese dhe të ujrave malore, si dhe pastrimi i vazhdueshëm i tyre sipas kërkesave të drejtorive të higjienës, duhet të bëhen rregullisht dhe të përcaktohen nga autoritetet vendore.

Një menaxhim dhe monitorim i kujdesshëm i mbetjeve dhe ujit, kanaleve kulluese, ujitëse, ndërtimit të strukturave dhe aktiviteteve të biznesit duhet të bëhet në bashkërendim me autoritetet vendore, duke përfshirë drejtoritë e higjienës dhe inspektoratet mjedisore. Në vijim jepen disa nga masat kryesore për t'u marrë në këtë drejtim:

- Inventarizimi i gropave të grumbullimit me ujë të ndotur ose jo, i shtëpive të banimit, veprimtarive tregtare/te biznesit duhet të kryhet përpara fillimit të përdorimit si dhe të merren masa për ndërtimin e gropave septike dhe për matjen e parametrave përkatëse;
- Zbrazja, pastrimi dhe higjienizimi i grumbullimit të ujërave sipas kërkesave të autoritetit të shëndetit dhe higjienës,
- Inventarizim i kanaleve kulluese përgjatë territorit në fjalë dhe pastrimi, mirëmbajtja e tyre për të arritur heqjen sa më të mirë të mundshme të ujërave nga sipërfaqja;
- Çdo iniciative për zgjerimin e veprimtarive ekzistuese, ndryshimin e destinacionit të tyre, çeljen e veprimtarive e reja të çfarëdolloj natyre, duke përfshirë edhe ato që ndërmerren për qëllime publike, etj., mund të kryhet vetëm pas pajisjes me lejet përkatëse nga autoritetet vendore dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit.

Duke qenë se në zonë nuk ka asnjë godinë të përdorur për qëllime tregtare, nuk është parashikuar

¹⁰ Monitorimi do të mbahet nga Eksperti Social i PIU-t deri në fillimin e punimeve, duke qenë se autoritetet vendore nuk janë ende të mirëpërcaktuara.

¹¹ Gjate përgatitjes së këtij raporti përgjegjësitë e autoriteteve vendore nuk janë ende të përcaktuara qarte si pasoje e Reformës Territoriale. Ja perse, këto zhvillime do të kryhen me vone, përpara përfundimit të investimit.

ndonjë shpërblim financiar për shkak të kufizimeve në këtë zonë.

3. S3 - Zona e Largët e Mbrojtjes Sanitare

Në këtë zonë e cila shërben si zonë zbutjeje, nuk lejohen të ketë zona të ndotura me ujë të ndotur, nuk lejohet të ketë zona të grumbullimit të ujërave të ndotura, depozita të mbetjeve duke përfshirë edhe ato kimike. Impianti i trajtimit të ujërave duhet të gjendet jashtë kësaj zone në një distancë të përcaktuar nga institucionet përkatëse shtetërore. Monitorimi i vazhdueshëm dhe masat e përgjithshme nga ndotja/kontaminimi janë të domosdoshme. Në këtë mënyrë, disa nga kërkesat kryesore të përcaktuara për zonën S2 do të zbatohen edhe në zonën S3. Mbetjet industriale në zonë, depozitimet e agentëve toksikë, mbetjeve kimike dhe minerale dhe saldimet, vend-depozitimet e agentëve kimike, vendet e caktuara për ruajtjen ose grosposjen e mbetjeve industriale, bujqësore, urbane, minierat e hapura dhe të mbyllura, etj., nuk lejohen pa siguruar autorizimet përkatëse sipas ligjit. Që prej fillimit të projektit e më tej, çdo ndërtim i ri në zonë duhet të pajiset me lejet e nevojshme nga autoritetet përkatëse shtetërore.

Masat kryesore që vijnë nga zona e tretë e mbrojtjes lidhen me kontrollin institucional në veprimtarinë e përditshme social-ekonomike të fshatrave dhe veprimtarisë së sipërmarrjeve që operojnë në zonë, duke marrë parasysh faktin se kufizimet e përshkrura në këtë dokument nuk çenojnë veprimtaritë ekzistuese social- ekonomike dhe të biznesit, asnjë kompensim nuk do të ofrohet për këtë qëllim.

Në funksion të një monitorimi efikas, utiliteti publik përfitues nga zbatimi i projektit, në bashkëpunim me autoritetet vendore dhe qendrore të mbrojtjes së mjedisit, do të ndërmarrë edhe trajnime dhe fushata ndërgjegjësuese, takime e biseda me banorët e zonës së puseve për të minimizuar risqet e mundshme mjedisore.

2.4. Kompensimi Financiar

Mundësia e kompensimit në të holla është parashikuar nga ligji shqiptar. PNP-të u konsultuan dhe preferojnë të holla kompensim për shpronësimin e tokës së tyre të nevojshme për zbatimin e projektit. Në të gjitha rastet, ky kompensim në të holla jepet për tokën bujqësore. Toka, përveç zonës S1, mbetet e shfrytëzueshme për bujqësi dhe veprimtari bujqësore.

- Përqindjet e sipërfaqes së tokës bujqësore do të shpronësohet për efekt të kompensimit janë llogaritur në konsultim me përfaqësuesit e familjeve të ndikuara për t'u siguruar që këta të fundit zotërojnë të paktën edhe një sipërfaqe tjetër toke në parcela të tjera brenda të njëjtës njësi administrative;
- Kompensimi për tokën është vlerësuar si i mjaftueshëm për t'iu mundësuar personave të ndikuar që të ruajnë nivelin e tyre të jetesës mbas shpronësimit;
- Në këtë RAP nuk është parashikuar kompensim për strukturat (ndërtesat, etj.);
- Pagesat e kompensimit duhet të bëhen para marrjes së sipërfaqeve përkatëse të tokës bujqësore në pronësi të shtetit (Ujësjellësi i Durrësit);
- Kompensimi për të ardhurat e humbura duhet t'u paguhet pronarëve siç është sqaruar më sipër në këtë dokument.

2.5. Vlerësimi i Kompensimit të Plotë

2.5.1. Përmbledhja e alternativave të pranueshme dhe mundësitë e kompensimit

Tabela 5. Kompensimi i llojeve të pronave

Asete të shpronësuara	Lloji i impaktit	Mbjajtësi i titullit të pronësisë	E drejta e kompensimit
<p>TOKË</p>	<p>Preket më pak se 80% e tokës totale nga projekti. Pjesa tjetër e tokës mbetet ekonomikisht e shfrytëzueshme.</p>	<p>Pronari / Mbjajtësi i Titullit të pronësisë</p>	<p>Kompensim në të holla (cash) për tokën e barabartë me vlerën e tregut të pronës, të mjaftueshme për të zëvendësuar pasuritë e humbura dhe për të mbuluar kostot e transaksionit. – Aplikohet Kompensim në të holla (cash) për asetet e humbura si dhe asistencë për rehabilitim, përfshirë punësimin ose trajnimin për punë të personave të prekur. – Nuk Aplikohet Asistencë Rehabilitimi për marrjen me qera të tokave alternative/pronave për rivendosje të aktiviteteve të tilla si kullotja. – Nuk aplikohet Asistencë tjetër: Për personat me aftësi të kufizuara, asistencë në komunikim me autoritetet përkatëse, që do të jepet nga Komiteti Lokal i Ankimeve për të lehtësuar procedurën e shpronësimit. – Nuk aplikohet</p>
<p>NDËRTESTA</p>	<p>Ndikohet më shumë se 80% e tokës. Pjesa tjetër e tokës mbetet ekonomikisht e pashfrytëzueshme.</p>	<p>Pronari/Mbjajtësi i Titullit të pronësisë</p>	<p>Kompensim në të holla (Cash) për tokën e prekur të barabartë me vlerën e tregut të pronës, të mjaftueshme për të zëvendësuar pasuritë e humbura dhe për të mbuluar kostot e transaksionit. – Nuk Aplikohet Kompensim në të holla (Cash) për asetet e humbura si dhe asistencë rehabilitimi, përfshirë punësimin ose trajnimin për punë të personave të ndikuar. – Nuk Aplikohet Asistencë Rehabilitimi për marrjen me qera të tokave alternative/pronave për rivendosje të aktiviteteve të tilla si kullotja. – Nuk aplikohet</p>
<p>KULTURA BUIQËSORE</p>	<p>Struktura të prekura plotësisht/pjesërisht</p>	<p>Pronari/Mbjajtësi i Titullit të pronësisë</p>	<p>Kompensim në të holla (Cash) për strukturat e prekura plotësisht ose pjesërisht dhe asetet e tjera të qëndrueshme pa amortizim. – Nuk aplikohet Të drejta për të shpëtuar materialet pa zbrifje nga kompensimi. – Nuk aplikohet Asistencë rehabilitimi nëse është e nevojshme (asistencë për punësim, trajnim). – Nuk aplikohet</p>
<p>PEMË</p>	<p>Kultura bujqësore të prekura nga përvetësimi i përhershëm/përdorimi i përkohshëm i tokës</p>	<p>Pronari/Mbjajtësi i Titullit të pronësisë</p>	<p>Kompensim në të holla (Cash) e barabartë me vlerën e tregut për kulturat e ndikuara. – Aplikohet (Vreshta, Ullinj, Grurë, Misër)</p>
<p>PËRVETËSIMI I PËRKOHSHËM</p>	<p>Pemë të prera</p>	<p>Pronari/Mbjajtësi i Titullit të pronësisë</p>	<p>Kompensim në të holla (Cash) bazuar në llojin, vjetërsinë dhe vlerën produktive të pemëve të ndikuara. – Aplikohet (Pemë Qershie, Pemë Kumbulle)</p>
<p>KUFIZIMI I PËRKOHSHËM</p>	<p>Përvetësimi i përkohshëm</p>	<p>Pronari/Mbjajtësi i Titullit të pronësisë</p>	<p>Zëvendësim i aseteve të prekura (p.sh. mure kufizuese të shkatërruara, pemë të dëmtuara, etj) në rast të ndonjë ndodhie gjatë ndërtimit të ujësjellësit, pas datës së vrojtit në terren. – Nuk aplikohet</p>
<p>KUFIZIMI I MBROJTJES</p>	<p>Përvetësimi i përkohshëm</p>	<p>Pronari/Mbjajtësi i Titullit të pronësisë</p>	<p>Kompensim në të holla për bizneset e prekura për shumën ekuivalente të 2 viteve të ardhura. – Nuk aplikohet Kompensim në të holla për aktivet e humbura dhe ndihmë për rehabilitim, duke përfshirë punësim ose trajnim për punë të personave të prekur. – Nuk aplikohet Ndihmë rehabilitimi për të marrë me qera truall-pronë tjetër për rialokimin e aktiviteteve si kullotja - Nuk aplikohet Kompensim në të holla për ndikimin nga kufizimi në përdorimin e fertilizantëve dhe pesticideve në të mbjella. – Nuk aplikohet Ndihmë tjetër: Për personat me aftësi të kufizuara do të ofrohet ndihmë në komunikimin me autoritetet përkatëse me rëndësi me qëllim lehtësimin e procedurave. - Nuk aplikohet</p>

2.5.2. Të dhëna mbi mundësitë e pranueshme, metodologjinë dhe kompensimin e PNP-ve

Kompensimi i Tokës: Në përcaktimin e vlerës së kompensimit për njësi të sipërfaqes së tokës bujqësore janë marrë parasysh metodat bashkohore të vlerësimit për efekt kompensimi, të dhënat në dispozicion për transaksionet e shitblerjes së tokës bujqësore, aktet ligjore në fuqi të lëshuara nga Qeveria shqiptare për shpronësimet për interes publik, çmimi për njësi i shpronësimeve për interes publik të kryer në zonën përkatëse, si dhe parashikimet specifike për këtë qëllim në dokumentet zyrtare të Bankës Botërore. Në tërësi, qëllimi kryesor ishte propozimi i një çmimi për njësi të sipërfaqes për kompensim që reflekton vlerën e tregut/vlerën e zëvendësimit të tokës në të cilën do të ndërtohet ujësjellësi i ri i Durrësit.

Në vijim jepet një pasqyrë analitike e gjetjeve mbi bazën e të cilave është sygjyeruar çmimi përkatës për njësi sipërfaqe dhe është llogaritur vlera e kompensimit të sipërfaqes S1 për ndërtimin e kësaj vepre të rëndësishme me interes publik siç është ujësjellësi i ri Durrësit. (Për më tepër shikoni Aneksin 1: Informacione për Vlerësimin e Kompensimit të Tokës).

Tabela 6. Pasqyra për llogaritjen e çmimit për shpronësimet e tokës bujqësore

Nr.	Komuna/Bashkia	Çmimi Min. (ALL/m ²)	Çmimi Max. (ALL/m ²)	Çmimi Mesatar (ALL/m ²)
1.	Çmimet për tokat bujqësore sipas Hartës së Çmimeve të Qeverisë Shqiptare	262	466	466
2.	Çmimet për tokat bujqësore sipas shpronësimit të tokave për ndërtimin e rrugëve (2006)	900	900	900
3.	Çmimet për tokat bujqësore sipas listës së çmimeve në transaksionet informale në Zonën e Puseve	150	1300	
	Çmimi paraprak i rekomanduar për shpronësimet:			1000(= 8\$/m ²)

Në aneksin nr. 1 të raportit mund të gjeni pasqyrat ndihmëse për llogaritjen e çmimi të rekomanduar.¹²

Kompensimi për Kulturat Bujqësore dhe Pemët: Metoda e vlerësimit për të përcaktuar këtë kompensim bazohet në Udhëzimin Nr.1, Datë 10.05.2000, "Për kriteret teknike të përlllogaritjes së vlerës së bimëve drufutrore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes".

¹² Rekomandimi i çmimit bëhet duke marrë në konsideratë analizën e mëposhtme:

- 1) Nga 8 pronare, 2 prej tyre kanë tokë në vijimësi territori të parcelës së tyre, e cila në vitin 2006 ka qenë shpronësuar nga qeveria për ndërtimin e Rrugës së Kombit dhe do të ishte e paarsyeshme/papranueshme që të ofrohej sot një çmim më i ulët se në atë kohë.
- 2) Gjatë periudhës 2006 e më tej inflacioni ka qenë të paktën 1,5-2,0% çdo vit.
- 3) Harta e vlerave e Qeverisë shqiptare (2014) ka ulur ndjeshëm çmimin dhe nuk justifikon shpronësimin.
- 4) Në këtë propozim çmimi nuk janë përfshirë dëmet për bimët e arave, pemët, etj.

Kriteret teknike në këtë udhëzim përdoren vetëm nëse nuk ka indikatorë të transaksioneve të deklaruar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP).

Sipas destinacionit bimët drufrutore janë:

- Bimët drufrutore që kultivohen për prodhimin e frutave të tyre.
- Bimët drufrutore “mëmë” që kultivohen për të marrë materiale shumëzimi për shtimin e tyre.
- Bimë drufrutore me vlerë gjenetike e të regjistruara si të tilla në Bankën Gjenetike pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve ose dhe në Institutin e Pemëtarisë;
- Bimë drufrutore që kultivohen me qëllim prodhimin e frutave të tyre dhe për rregullimin e mjedisit banues ose/dhe biznesit;
- Fidanishtet me të gjitha strukturat e prodhimit dhe materialet mbjellëse dhe të shumimit të bimëve drufrutore.

Përlllogaritjet e vlerave të druve frutorë dhe kulturave të tjera sipas metodës së “kostove të zëvendësimit” për investimet dhe kostot faktike të aktivitetit, duke marrë parasysh vlerat e kostos së punës, pajisjeve dhe materialeve në kohën e vlerësimit. Vlerat e marra parasysh nga legjislacioni shqiptar janë si më poshtë:

- Vlera në periudhën e rritjes (V1), në të cilën përfshihen investimet fillestare, investime të tjera që i shërbejnë bimësisë (sistemi kullimi, ujitje, mbështetje, mbulimi), investimet për shërbimet vjetore, kostot oportune të periudhës së rritjes,
- Vlera e prodhimit të pritshëm (V 2), e cila sipas udhëzimeve të BB duhet të përlllogaritet me çmimin e vitit të kaluar të firmës;
- Vlera të tjera (V 3) shton specifikat përkatëse të rastit, si rasti i regjistrimit në Bankën Gjenetike, rastet e bimës “mëmë”, kur bimësia është pjesë e mjedisit banues të PNP;
- Vlera që bëhen zbritje (V4) të cilat janë raste të ndryshme të kostove të amortizimit.

Sipas përvojës së Bankës Botërore, gjithashtu zbatohet edhe metoda e “Kostos së Zëvendësimit” të asetëve, e cila ndihmon për përcaktimin e shumës së mjaftueshme financiare për të zëvendësuar asetet e humbura dhe të mbulojë kostot e transaksionit. Ajo çfarë dallon në teknikat e sipërpërmendura është se Banka Botërore përdor çmimet aktuale të tregut të bimëve dhe të prodhimit për një zëvendësim të drejtë dhe nuk marrin parasysh amortizimin e strukturave dhe të asetëve¹³. Për këtë arsye, në përlllogaritjet e mësipërme nuk është marrë parasysh amortizimi i sqaruar si më sipër.

Për kulturat foragjere vlera e kompensimit llogaritet duke u bazuar në prodhimin e pritshëm dhe çmimin për njësi, duke marrë parasysh kostot e investimit për kryerjen e punimeve përkatëse bujqësore. Në tabelën e mëposhtme, mbështetur në të dhënat në dispozicion, paraqitet vlera e sygjeruar e kompensimit gjithsej. Tabela ndan kompensimin në marrjen në pronësi të tokës nga shtetit, humbjen e kulturave dhe tregon gjithashtu mungesën e kompensimit për llojet e tjera të përmendura në këtë dokument.

Vlera gjithsej e kompensimit të llogaritur për realizimin e Projektit Shqiptar të Investimit të Ujit është 7741082.3 lekë shqiptare (ALL).

¹³ OP 4.12 – Rivendosja e Pavullnetshme, Masa të Nevojshme, Dhjetor 2001 (Rishikuar Prill 2003)

Tabela 7. Pasqyra e të dhënave të kompensimit

Nr	Komuna / Fshati	Emër Mbiemër i Pronarit	Nr. Parcele	Sip	Kompensimi per Token	Kompensim Total Bimesia	Kompensim Total
1		Tokë/Pronë Shtet (Danjel Marku, i biri i Kol Marku sipas ligjit 7501)	35/27	625.0	625000	142868.2	767868.2
2		Ndue Lazer Mhilli (Mark Mhilli, i biri. Pronësia e paregjistruar ne emër te tij ende)	40/14	625.0	625000	24725.0	649725.0
3		Loro Gjon Kolaj	38/17	625.0	625000	495487.5	1120487.5
4	Milot / Fushe Milot	Ismet Taf Veseli	43/2	312.5	312500	61500.0	374000.0
5		Xhumaile Adbulla Veseli	43/44	312.5	312500	49174.1	361674.1
6		Murat Hasan Veseli	42/26	625.0	625000	420890.0	1045890.0
7		Dervish Zenel Haxhiu (Djemtë: Musa, Kujtim, Fatmir Haxhiu në proces regjistrimi të pasurisë)	43/19	625.0	625000	98348.2	723348.2
8		Lec Marashi	*	250	250000	39939.3	289339.3
9	Fushëkuqe /Adriatik	Nikolle Gjenci	*	100	100000	0.0	100000.0
10		Kanto Gjenci	*	187.5	187500	15000.0	202500.0
11		Tofik Lleshi	444/4	150.0	150000	0.0	150000.0
12		Besnik Bregu, Petrit Ruka	444/10	62.5	62500	0.0	62500.0
13		Artan Dyrmishi	444/11	68.8	68750	0.0	68750.0
14		Leonard Buda	444/6	143.8	143750	0.0	143750.0
15	Ishëm/Bize	Idri Metollari	444/14	37.5	37500	0.0	37500.0
16		Tatjana Gjepali	444/15	37.5	37500	0.0	37500.0
17		Shpresa Nasi	444/16	37.5	37500	0.0	37500.0
18		Lulzim Kastrati	444/12	75.0	75000	0.0	75000.0
19		Drita Kuci	444/8	50.0	50000	0.0	50000.0

20	Selirm Mita	445/8	62.5	62500	0.0	62500.0
21	Mitat Hebibaj	445/11	62.5	62500	0.0	62500.0
22	Ndue Jaku	445/30	93.8	93750	0.0	93750.0
23	Hasan Selita, Etleva Selita	445/31	81.3	81250	0.0	81250.0
24	Xhemal Bafti, Sherife Bafti, Mimoza Bafti, Nazir Bafti	445/32	81.3	81250	0.0	81250.0
25	Edlira Hamataj	445/33	12.5		0.0	
		445/34	81.3	218750	0.0	218750.0
		445/35	125.0		0.0	
26	Hariz Piluri, Violeta Piluri	445/36	125.0	125000	0.0	125000.0
27	Luan Saraci, Fetah Kazia, Hamza Kazia, Baftjar Kazia, Qani Hysa, Gentian Meta	445/37	81.3	81250	0.0	81250.0
28	Samir Gjepali	445/38	62.5	62500	0.0	62500.0
29	Veli Kajmaku	445/53	37.5	37500	0.0	37500.0
30	Shpresa Sofija	445/50	93.8	93750	0.0	93750.0
31	Avni Fida	444/54	93.8	93750	0.0	93750.0
32	Sukth / Hamallaj	58/11	350	350000	0.0	350000.0
			6393.8	6393750.0	1347332.3	7741082.3

3. Konsultime me personat e prekur nga projekti (PNP) mbi mundësitë e pranueshme

3.1. Objektivat e konsultimeve dhe e informimit publik

Në procesin e përgatitjes së Plan-Veprimit për Shpronësim të Shkurtuar ishte e nevojshme të shpërndahej informacion mbi projektin e investimit dhe për këtë qëllim të realizoheshin takime konsultative me PNP-të. Shpërndarja e informacionit me treguesit kryesorë të investimit dhe përfshirja sa më e gjerë e komunitetit dhe veçanërisht e PNP-ve në diskutimin rreth tyre janë të domosdoshme për të zvogëluar riskun e vonesave në zbatimin e projektit.

Objektivat specifike të fushatës publike të informimit dhe konsultimeve publike kanë qenë si më poshtë vijon:

- a) Të shpërndahej informacion sa më i plotë ndër personat e prekur nga projekti mbi investimin e parashikuar, shtrirjen dhe komponentët përbërës të tij;
- b) Të përfitohet informacion mbi nevojat social-ekonomike dhe përparësitë e personave të prekur, si edhe informacion mbi reagimet e tyre ndaj politikave dhe aktiviteteve të propozuara;
- c) Të jepet informacion mbi opsionet e mundshme për shpronësimin dhe metodat e njohura të shpërblimit;
- d) Të arrihet një bashkëpunim dhe pjesëmarrje e personave të prekur dhe komunitetit në veprimtaritë e domosdoshme për t'u ndërmarrë në procesin e planifikimit dhe të zbatimit të shpronësimin;
- e) Të sigurohet transparenca në të gjitha veprimtaritë e lidhura me marrjen e tokës, shpronësimin dhe masat rehabilituese.

3.2. Procesi i Informimit Publik

Informacioni mbi projektin iu ofrua fillimisht Komunave, Kryetarëve të fshatrave dhe komuniteteve të prekura nga furnizimi i ri me ujë përmes përmbledhjeve të shkurtra, takimeve në zonën e prekur dhe konsultimeve. Komunitetet u informuan përgjatë zhvillimit të census-it dhe gjatë takimeve konsultuese mbi objektivat e projektit, ndikimet dhe përfitimet e parashikuara ndaj PNP-ve dhe popullatës përfituese.

Në takimet konsultuese u ftuan ekspertë nga institucionet vendore dhe qëndrore, si dhe përfaqësues të komunitetit. Konsultimet publike me PNP-të u zhvilluan në të gjitha zonat e prekura nga projekti. Në këto takime konsultimi, autoritetet vendore treguan një bashkëpunim të frytshëm dhe mundësuan lehtësim për procedurat dhe për komunikimin. Konsultimet bënë të mundur që njerëzit të merrnin informacionin e nevojshëm, pavarësisht procedurave për Planin e Rivendosjes.

Këto takime u zhvilluan përgjithësisht pas takimeve personale me PNP-të dhe shërbyen për t'u paraqitur PNP-ve projektin dhe vazhdimësinë e tij, për të diskutuar detaje të vendndodhjeve specifike të zonave të prekura nga shpronësimet, për të realizuar mbledhjen paraprake të dokumentacionit, për t'u dhënë shpjegime dhe informacion aktorëve pjesë e projektit në të gjitha proceset, për të folur për procedurat që do të ndërmerren në të ardhmen dhe për të folur për të drejtat e pronarëve të shpronësuar.

Më në veçanti takimet konsultuese kanë pasur edhe këto objektiva, të lidhura me të drejtat e PNP-ve:

- Komunikimi i vazhdueshëm me të gjithë PNP-të e prekur;
- Shpjegimi i qëllimit të takimit: të jepet informacion mbi shpronësimet dhe të jepet mundësia për që njerëzit të ngrenë shqetësimet e tyre;

- Mbulim i mëtëjshëm i të gjitha problemeve të lindura në diskutimet e konsulentit me pronarët privatë të tokave gjatë takimeve individuale;
- Ofrimi i shpjegimeve dhe asistencës apo edhe këshillimit mbi procesin e shpronësimit dhe mbi kuadrin ligjor që rregullon procesin në të gjithë hapat e tij;
- Ndërgjegjësimi i personave të prekur nga ky investim publik për procedurat ligjore që duhet të ndjekin në raste të mosdakordësisë së tyre me vlerën e shpërblimit dhe/ose sipërfaqen për t'u shpronësuar;
- Shpjegimi i procesit të ankimit të lidhur me kompensimin, pronësinë ose ankesa të tjera;
- Lehtësimin e marrjes së sygjërimeve të ndryshme dhe shqetësimeve.

Metodologjia e përdorur për realizimin e takimeve ishte ajo e takimeve të drejtpërdrejta dhe mjetet e përdorura për tu siguruar për praninë e PNP-ve ishin:

- Komunikimi telefonik me PNP-të,
- Takimet individuale me PNP-të,
- Njoftim, shpërndarje informacioni në komunitet përmes ndihmës së Njësisë të Qeverisë Vendore (NjQV).

4. Përgjegjësitë Institucionale për Zbatimin, Ankimit dhe Kompensimin

4.1. Përgjegjësitë institucionale për zbatimin e projektit

MTI ka përgjegjësinë përfundimtare për zbatimin e të gjithë komponentëve të projektit së bashku me Njësinë e Sektorit të Ujërave Zbatimit të Projektit (NjZPU). Një komision i përbërë nga PNP/Autoritetet e Projektit do të krijohet për të qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të RAP.

NjZPU do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet lokale për të siguruar zbatimin e suksesshëm të RAP.

Bashkia Durrës (Shërbimi i Ujësjellësit Durrës) është përfituesi përfundimtar i zbatimit të projektit. Nga institucioni kërkohet mbështetje e vazhdueshme dhe prania përgjatë gjithë ecurisë së projektit.

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) për çdo Qark në zonën e Projektit, nën autoritetin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, janë përgjegjëse për identifikimin dhe verifikimin e kufijve të pronave dhe pronësisë.

Zyrat e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ish-Zyrat Kadastrale) në Qark, do të qartësojnë certifikatat e ndarjes së tokës për tokat bujqësore, që nuk janë regjistruar dhe transferuar formalisht në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Bashkitë dhe Rajonet do të jenë përgjegjëse për koordinimin e procedurave të zbatimit dhe ekzekutimit të kompensimit.

Tabela 8. Rregullimet Institucionale për Zbatim

Hapa	Institucioni	Përshkrimi i përgjegjësisë	Koha	Vërejtje
Planifikimi i RAP				
Hapi I	Njësia e Zbatimit të Projekteve të Ujit (NJZPU)(ose konsulentit në emër të NJZPU)	Identifikimi i PNP-ve, informacion publik, përlogaritja e vlerës së RAP		Informacion mbi ndikimet e projektit, nevojat e RAP, vlerësimi dhe verifikimi i PNP-ve
Hapi II	NJZPU (ose konsulentit në emër të NJZPU)	Konsultimi me PNP-të		Shpjegim mbi aktivitet që do të preken, identifikimi i mënyrës më të mirë për kompensim, shpjegimi i kohës së kompensimit, aktorët kryesorë në procesin e zbatimit, procedurat që duhet të ndërmerren dhe të drejtat për ankimim.
Hapi III	NJZPU (ose konsulentit në emër të NJZPU)	Përgatitja e raportit përfundimtar të RAP		Përgatitja e raportit përfundimtar të RAP duke marrë parasysh komentet e MTI dhe BB
Hapi IV	MTI	Aprovimi i raportit përfundimtar		Formalizimi i raportit të RAP dhe përfshirja në Termat e Referencës së zbatimit të projektit
Hapi V	NJZPU, Shërbimi i Ujësjellësit Durrës, Bashkia Durrës	Krijimi i Komitetit të Ankimeve		Komiteti i Ankimeve (Mekanizmi i Menaxhimit të Ankesave) do të formalizohet dhe kontaktet e veçanta duhet t'ju jepen PNP-ve
Zbatimi i RAP				
Hapi VI	NJZPU MTI	Kërkesë për shpronësim për interes publik	1 javë pas miratimit të RAP	Plotësimi i kriterëve të parashikuara me ligj, veçanërisht dokumentet e nevojshme që provojnë nevojat e shpronësimit
Hapi VII	MTI	Komisioni i Shpronësimeve të MTI duhet të shyrtojë kërkesën dhe dokumentet	2 javë pas miratimit të RAP, pas kërkesës për shpronësim	Ngritja e Komisionit të shpronësimit, verifikimi i dokumentacionit mbi pronat, llogaritja dhe verifikimi i vlerës së kompensimit
		Nëse kushtet ligjore plotësohen MTI fillon procesin e shpronësimit		
Hapi VIII	NJZPU, Komiteti i Ankimeve	Nëse jo kërkesa do të refuzohet	3 javë pas miratimit të RAP	Vlerësimi i përputhshmërisë ndërmjet kërkesave të palëve të interesuara

Hapi IX	Autoritetet Vendore MTI/PNP-të	legjislacionin shqiptar dhe udhëzimet e BB dhe marrin parasysh kërkesat e PNP-ve.	4 javë pas miratimit të RAP	Të japë zgjidhje dhe të nxisë marrëveshjet duke mbështetur kërkesat e PNP-ve në legjislacion
Hapi X	MTI	Marrëveshja me PNP-të për shpronësimet	5 javë pas miratimit të RAP	E rëndësishme: Vlerësimi i drejtë i pronave
		Publikimi i njoftimit për shpronësim - Shpallja		Procedura duhet të ndiqet me kujdes dhe të respektohet e drejta e personave të tretë për të parandaluar ankimmimin në Gjykatë
		Shqyrtimi i sugjerimeve dhe ankesave të personave të ndikuar nga procesi		Shpronësimi do të bëhet për personat do të pranojnë me vullnet të lirë për t'u kompensuar me kushtet e publikuara.
		Përgatitja e Projekt - Vendimit të Këshillit të Ministrave		Përgatitja e VKM-së dhe kompensimit të PNP
Hapi XI	Këshilli i Ministrave	Të miratojë vendimin e shpronësimit për interes publik ose hedh poshtë propozimin e MTI me sugjerimin për ta rishikuar, nëse nuk është në përputhje me ligjin. I paguan kompensimin personave të ndikuar nga shpronësimi, para se të fillojnë punimet.	9 javë pas miratimit të RAP	VKM do të zbatohet 1 muaj pasi botimit në fletoren zyrtare
Hapi XII	NjZPU (ose konsulenti në emër të NjZPU)/ Komiteti i Ankimeve	Asistencë në marrëdhënien mes PNP-ve dhe autoriteteve lokale dhe qeveritare, verifikimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të RAP	10 javë pas miratimit të RAP	Verifikimi i përputhshmërisë së marrëveshjes në mes palëve të interesuara.
Hapi XIII	NjZPU (ose konsulenti në emër të NjZPU)/ Komiteti i Ankimeve	Nëse është e nevojshme, mbështetje ndaj PNP-ve mbi procedurat e ankesave për organet administrative, procedurat e RAP, vlera e kompensimit etj dhe mbështetje për ankesat e PNP-ve në Gjykatë	11 javë pas miratimit të RAP	Nëse PNP-të do të kenë ankesa.
Hapi XIV	PNP	Hapja e një llogarie bankare dhe raportimi në MTI	12 javë pas miratimit të RAP	Mbështetje institucionale në procesin e kompensimit
Hapi XV	MTI	Të kryejë pagesën e kompensimit të	14 javë pas miratimit të RAP	Të sigurohet që kompensimi është bërë sipas (shumën dhe

		shpronësimit përpara se puna civile të fillojë	miratimit të RAP	kohën) marrëveshjes së nënshkruar nga palët e interesuara dhe para fillimit të zbatimit të projektit
Hapi XVI	OJF	Të sigurojë që zbatimi i procesit ka marrë parasysh të gjitha pretendimet e palëve të interesuara.	14 javë pas miratimit të RAP	Të sigurohet që kompensimi është bërë sipas (shumën dhe kohën) marrëveshjes së nënshkruar nga palët e interesuara.
Hapi XVII	NJZPU	Përgatitja e raportit përfundimtar për zbatimin e RAP	15 javë pas miratimit të RAP	Duke pasur parasysh se kompensimet duhet të përfundojnë përpara fillimit të zbatimit të projektit
Hapi XVIII	MTI, PNP, NJZPU dhe OJF	Caktimi i procesit të publikimit sipas kërkesave të palëve të interesuara dhe në lidhje me VKIM	15 javë pas miratimit të RAP	Të sigurojë një dokument të nënshkruar që tregon se ARAP është përfunduar dhe kompensimet janë kryer.
			Përmbyllja e RAP	Ky dokument gjithashtu do të verifikojë në të ardhmen që tokat e shpronësuara janë pronësi e MTI-së

4.2. Procedurat për ankimim

Ankesat janë një dukuri e zakonshme në rastet e rivendosjeve/shpronësimeve të pavullnetshme të cilat, nëse nuk zgjidhen me mirëkuptim dhe në kohën e duhur, shkaktojnë rritje të rezistencës lokale, tensione politike dhe vonesa të panevojshme në zbatimin e projektit. Për shqyrtimin e ankesave për këtë projekt duhet të krijohet një mekanizëm që të adresojë shqetësimet e mundshme legjitime të PNP-ve, të cilët mund t'a konsiderojnë veten të privuar nga trajtimi i duhur gjatë këtij projekti.

Mekanizmi do të krijohet nga NjZPU dhe do të funksionojë te përfituesi i zbatimit të projektit (Ndërrmarrja Ujësjellës-Kanalizime Durrës) dhe duhet të përfshijë këto çështje kryesore:

- një sistem regjistrimi dhe raportimi të dokumentuar, në të cilin të përfshihen ankesat e paraqitura si me gojë, ashtu edhe me shkrim,
- staf i përgjegjshëm në nivele të ndryshme të qeverisjes, dhe
- një afat kohor për të adresuar ankesat e paraqitura.

Funksionimi i mekanizmit të shqyrtimit të ankesave duhet të monitorohet rregullisht dhe të vlerësohet nga NjZPU gjatë zbatimit të projektit dhe nga Monitorimi i Brendshëm. Do të jetë patjetër edhe subjekt i kontrolleve nga Monitorimi Përfundimtar i Jashtëm.

Për qëllimet e RAP sugjerohet që të krijohet një mekanizëm jozyrtar i ankesave që mund të ndihmojë për të shmangur sa të jetë e mundur nevojën për t'u drejtuar tek autoritetet formale zyrtare. Ky mekanizëm do të formohet nga NjZPU dhe përfshin:

- 1 përfaqësues nga përfituesi Shërbimi i Ujësjellësit të Durrësit
- 1 përfaqësues të PNP-ve,
- 1 përfaqësues i cilësuar si "asnjanës" nga zona e prekura (zyrtar i pushtetit vendor ose i qarkut, i cili do të përzgjidhet/caktohet sapo përgjegjësitë, emërimet dhe mbulimi i njësive të administratës vendore do të vendosen).

Funksionimi i mekanizmit të menaxhimit të ankesave duhet të monitorohet dhe vlerësohet rregullisht nga NjZPU-ja gjatë zbatimit të projektit dhe duhet të jetë gjithashtu subjekt i monitorimit të brendshëm.

Në parim, mekanizmi i ankesave është një qasje e lehtë, mekanizëm pa kosto, që përfshin njerëz nga komuniteti, projekti dhe autoritetet përkatëse për të menaxhuar dhe zgjidhur problemet para se ata të kalojnë nëpërmjet kanaleve zyrtare, të cilat duan kohë dhe kanë kosto.

Së fundi, krijimi i këtij komiteti *sui generis* është menduar për të lehtësuar ndjeshëm çdo çështje me PNP-të dhe për të zvogëluar shpenzimet e tyre administrative, duke pasur parasysh se zonat e ndikuara janë larg Tiranës dhe të gjitha procedurat e ankimimeve kryhen në Tiranë.

Përfaqësuesi i Ujësjellësit të Durrësit do të kryesojë komisionin dhe do të ndihmojë në shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave sipas ligjit. Komiteti do të regjistrojë të gjitha ankesat e pranuar, rezultatit e përpjekjeve për të zgjidhur këto ankesa dhe këtë informacion do t'a përfshijë në raportin e monitorimit dhe vlerësimit.

Ligji "Mbi Shpronësimin" parashikon një proces ankimimi kundër vendimit të propozuar për kompensim. Për më tepër, ligjet për planifikimin urban dhe politikat e ndërtimit mundësojnë edhe ankesat administrative të palës që shpronësohet. Ankesat e mëtejshme mund të bëhen në gjykatën

e qarkut. Gjithashtu, Zyra e Avokatit të Popullit në Tiranë pranon të shqyrtojë ankesat nga qytetarët kundër veprimeve të qeverisë që prekin të drejtat e tyre. Stafi i projektit do të kontribuojë gjithashtu në ndërgjegjësimin e PNP-ve dhe të komunitetit rreth të drejtave të tyre, si dhe në zgjidhjen e ankesave të rastit.

Siç dihet, qeverisja vendore e Shqipërisë aktualisht po kalon një periudhë tranzicioni sipas një skeme të re në zbatim të reformës administrativo-territoriale. Si rrjedhojë, njësitë e reja vendore pritet të jenë funksionale gjatë muajve në vijim deri në fund të vitit. Në këto kushte ka qenë i pamundur krijimi i mekanizmit të ankimeve përpara përmbylljes së këtij dokumenti (RAP).

5. Monitorim dhe Vlerësim

Monitorimi i zbatimit të RAP dhe vlerësimi i impaktit social, ekonomik dhe mjedisor përbën një element të rëndësishëm për respektimin e kushteve ligjore, institucionale, mjedisore dhe social-ekonomike të lidhura me projektin në fjalë.

Në tërësinë e institucioneve të përfshira, rolin kryesor do t'a luajë përfituesi (Ujësjiellësi i Durrësit) i mbështetur nga NjZPU dhe autoritetet vendore. Ndërkaq, deri në përfundimin e ndërtimit të ujësjiellësit, Komiteti i Ankimeve do të mbështetet dhe asistohet gjerësisht nga NjZPU, me qëllim që RAP të zbatohet me rigorozitet dhe në afatet përkatëse. Në të njëjtën kohë, në funksion të monitorimit të zbatimit të RAP, do të aktivizohet edhe Monitorimi i Brendshëm dhe Monitorimi i Jashtëm.

Detyrat specifike dhe mënyra e funksionimit të këtyre monitorimeve jepet në vijim.

5.1. Monitorimi i Brendshëm

Rekomandohet që NjZPU-ja të ngarkohet me detyrën e monitorimit dhe vlerësimit të PNP-ve, procedurave të lidhura me kërkesat e tyre dhe ankesat. Siç edhe është përmendur më sipër, NjZPU-ja do të jetë përgjegjëse për iniciimin dhe vënien në funksion të dy njësive monitoruese ad-hoc:

- Monitorimi i Komitetit të Ankimeve
- Monitorimi i Brendshëm i Përgjithshëm

Përsa i takon problematikës, veprimtaria e Monitorimit të Brendshëm lidhet kryesisht me takimet publike, census-in, inventarin e asetëve, vlerësimet dhe studimin socio-ekonomik, ankesat e pranura dhe statusi i tyre, pagesat e kompensimit të disbursuara, paraqitjen e raportit të monitorimit.

Raportet e monitorimit të brendshëm duhet të përgatiten dhe të dorëzohen në Drejtorinë e NjZUP-së dhe të ndahen me partnerët dhe specialistët e tjerë të përfshirë për të shërbyer për raportin RAP në përfundim të investimit në këtë vepër publike.

5.2. Monitorimi i Jashtëm dhe Vlerësimi

Një njësi e pavarur monitorimi (NjPM) duhet të përfshihet në vlerësimin e zbatimit/kompensimit dhe shpronësimit. Kjo njësi duhet të pëzgjidhet për të monitoruar procesin e shpronësimit dhe kompensimit, si dhe zbatimin e kërkesave për të verifikuar nëse kompensimi është zbatuar në përputhje me RAP dhe të rënë dakord nga autoritetet shtetërore. Gjithashtu, kjo njësi do të përfshihet në procedurat e ankimit për t'u siguruar që problematika e ngritur nga PNP është adresuar rregullisht. Specifikisht, kjo njësi do të ketë këto funksione kryesore:

- Rishikimin e rezultateve të monitorimit të brendshëm dhe rishikimin e ankesave të përgjithshme lidhur me RAP;

- Kontrolle të rastësishme në terren për të verifikuar: pagesën e kompensimit dhe kohën e pagesës;
- Intervista me kampione rastësore nga njerëzit e prekur nga projekti në njësi të ndryshme administrative për të vlerësuar njohuritë/dijeninë e tyre me procesin e shpronësimit dhe në lidhje me të drejtat e tyre pronësore;
- Të kontrollojë llojet e ankesave të bëra dhe funksionimin efektiv të mekanizmit të menaxhimit të ankesave;
- Të vlerësojë efektivitetin e përgjithshëm të shpronësimit dhe të formulojë gjetje/konkluzione për t'u përdorur si guidë në të ardhmen;
- Të përcaktojë përshtatshmërinë e plotë të të drejtave për të përmbushur objektivat.

Rekomandohet që përfituesi (Drejtoria e Ujësjellës-Kanalizimeve Durrës) të pajtojë NjPM ku të përfshihen ekspertë me përvojë në rastet e shpronësimit dhe çështjeve sociale.

Ecuria dhe performanca e RAP do të vlerësohet para, gjatë dhe pas zbatimit të tij. Duke përdorur informacionin bazë që është mbledhur gjatë hartimit të këtij RAP, Drejtoria e Ujësjellës Kanalizimeve Durrës së bashku me NjZP-në do të jenë në gjendje të konstatojnë ndryshimet social-ekonomike që mund të kenë ndodhur përpara dhe pas shpronësimeve që do të kryhen për t'i hapur rrugën fillimit të zbatimit të projektit.

6. Afatet dhe buxheti

Fazat	Javë														
	J1	J2	J3	J4	J5	J6	J7	J8	J9	J10	J11	J12	J13	J14	J15
Kuadri i Politikave të Rivendosjes															
Aktivitetet e RAP - Vizita në terren - CENSUS - Konsultime me Fokus Grupet															
Të gjithë PNP të informuar															
Hapat e fundit për përmbylljen e RAP															
Publikimi i RAP															
Përgatitja e Letrës njoftuese nga NIZPU njësjive vendore dhe PNP për shpronësim															
Krijimi i Komitetit të Ankimimeve të Projektit (PNP-Projekt-Autoritetet)															
Procedurat për Shpronësim të nisura nga MTI															
Shpronësimi dhe kompensimi i PNP															
Aktivite informuese për RAP															
Masat e adresimit të ankimimeve															
Fillimi i punimeve															
Vlerësimi i monitorimit dhe dëmtimeve të mundshme (ndryshime të fundit)															
Raporti përmbyllës															

Aneks 1. Informacione për Llogaritjen e Çmimit të Rekomanduar

Pasqyra 1. Lista zyrtare e shpronësimeve nga ndërtimi i korridorit Durrës-Morinë (seksioni Milot-Rrëshen; fshatrat: Fushe milot, mal i bardhe)¹⁴

Nr	Emër Atësia Mbiemër	Nr Pasurie	Sip (m2/)	Çmim ALL/m2	Vlera Totale (Përfshin vlerësimet ne total për token bujqësore, trojet, kulturat bujqësore dhe pemët)
1	Nikoll Mark Marku	37/35	1325	900	1626302
2	Mark Ndue Mehilli	91/29	144	900	151611
3	Ismet Taf Veseli	43/2	963	900	873460
4	Murat Veseli	42/19	912	900	936002
5	Isuf Caf Veseli	42/18	57	900	67200
6	Caf Dervish Veseli	43/12	594	900	538770
7	Mehmet Hajdar Veseli	44/9	4448	900	4228925
8	Skender Anxhaku	29/14	646	900	581400
9	Pa Identifikuar	109/1	80	900	72000
10	Pal Pjeter Cerri	107/1	799	900	719100
11	Adem Sul Shabani	28/20	427	900	384300
12	Altin Gjon Biba	29/24	350	900	315000
13	Veli Hasan Veseli	43/16	558	900	751617
14	Asllan Nezir Lika Lika	92/1	825	900	748292
15	Ramazan Shaban Kapllani	44/4	990	900	897950
Çmim mesatar				900	ALL/m2

¹⁴ Bazuar në Aktin nr. 24, date 24.11.2006 "Për Shpronësimin në interes publik, të pasurive të paluajtmshme, pronë private, të prekura nga ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Rrëshen, pjesë e korridorit Durrës-Morinë. http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2006/PDF-2006/121-2006.pdf

Pasqyra 2. Harta e Vlerave të Shpronësimit Rrethi Kurbin sipas VKM (2014)

Vlera e Pasurisë së Paluajtshme të Llojit toke truall për rrethin Kurbin (2014)			
Nr	Fshati	Zona Kadastrale	m ² Toke Truall /ALL
1	Adriatik	1673	333
2	Delbnisht	1458	271
3	Droje	3976	271
4	Fer Shkopet	3470	333
5	Fushë Kuqe	1673	333
7	Fushë Mamurras	1676	357
8	Fushë Milot	1677	333
9	Gallate	1688	271
10	Gernac	1703	271
11	Gjorm	1768	351
12	Gorre	1812	466
13	Gurez	1890	271
14	Katund i Ri	2120	271
15	Lac (Fshat)	2365	278
16	Mal Bardhe	2580	301
17	Mal Milot	2581	271
18	Patok	2889	271
19	Prozhime	2693	271
20	Qyteti Milot	2693	271
21	Selite	3295	271
22	Shellime	3332	271
23	Shemri	3336	271
24	Shkopet	3391	271
25	Shperdhet	3412	262
26	Shullaze	3441	333
27	Skuraj	3469	271
28	Vinjolle	3780	271
29	Zheje	3924	342

Aneks 2. Akt-Marrëveshje Tip midis Njësive të Qeverisjes Vendore dhe PNP-ve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AKT MARRËVESHJE

Kjo Akt Marrëveshje hartohet në datë _____

Midis **Bashkisë** _____, e përfaqësuar nga Z. _____, më poshtë i referuar si "Bashkia",

Dhe

_____, i biri/e bija i _____, lindur më _____, në _____ dhe banues në _____, me nr. ID _____, në zotërim të pronësisë nr. _____ në _____, Zona Kadastrale _____, me dokument pronësie _____ nr _____ të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës më datë _____, i referuar si "Pronari"

Kuadri ligjor : Kjo akt marrëveshje hartohet në bazë të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për Qeverisjen Vendore" (i ndryshuar), ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", ligjit nr. 115/2014 datë 31.7.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore" i ndryshuar, Rregullores Higjieno-Sanitare të miratuar me VKM nr. 145, datë 26.02.1998 dhe Udhëzimit Nr. 1 të datës 5.10.2000 të Ministrisë së Bujqësisë "Për kriteret teknike të përlllogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes".

- Duke u bazuar në parashikimet e ligjit, në misionin e tij pushteti vendor përfshin qeverisjen duke respektuar të drejtat dhe parimet themelore të lirisë së qytetarit, të sanksionuara në Kushtetutë, siç edhe është e drejta e pronës;
- Duke pasur parasysh që zbatimi i planit të investimit për furnizimin me ujë të pijshëm të Qarkut të Durrësit, sipas Projektit Shqiptar të Investimit në Sektorin e Ujit, kërkon që procesi i shpronësimit të pronarëve i kryer për interes publik të realizohet përpara fillimit të zbatimit të projektit;
- Duke pasur parasysh që Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, pjesë e Grupit të Bankës Botërore, financuese e projektit të investimit, ka përcaktuar qartazi në politikat e saj sociale dhe ekonomike të aplikuara në zbatimin e projekteve të ngjashme, që kushti paraprak për procesin e shpronësimit është kompensimi i plotë i pronarëve të prekur (edhe në mungesë të titullit të pronësisë), mbrojtja sociale dhe gjetja e zgjidhjeve të përshtatshme për zhvendosjen/ shpronësimin e tyre. Marrëveshja midis Bankës Botërore dhe Qeverisë së Shqipërisë qëndron mbi legjislacionin e vendit në përgatitje dhe zbatim të këtij projekti.
- Duke vlerësuar se Bashkia në bashkëpunim me Njësinë e Zbatimit të Projektit të Ujit ka përfunduar identifikimin fillestar të pronësisë së Z/Znj _____, sipas dokumenteve të pronësisë bashkangjitur akt-marrëveshjes në Aneksin 2 si dhe duke qenë se Këshilli i Ministrave ka nisur procedurën e shpronësimeve për interes publik;

Për sa më sipër me synimin e realizimit të Projektit Shqiptar të Investimit në Sektorin e Ujit në interes publik të Republikës së Shqipërisë palët bien dakord si më poshtë:

I. Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Qëllimi i Akt Marrëveshjes

Kjo akt marrëveshje hartohet në zbatim të Projektit Shqiptar të Investimit në Sektorin e Ujit midis Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore, i cili përfshin ndërtimin e një sistemi të ri për furnizimin me ujë të qytetit të Durrësit, që prej burimit në komunën e Milotit (rrethi i Lezhës) deri në qytetin e Durrësit.

Neni 2

Objekti i Akt Marrëveshjes

Objekti i akt marrëveshjes është rënia dakord për shpronësimin e tokës në kuadër të zbatimit të projektit për interes publik, të sipërfaqes prej ____ m² sipas kushteve të shprehura më poshtë në akt marrëveshje.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë akt marrëveshje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Shpronësimi për interes publik" është kalimi i pronësisë nga pronësia private në pronësi shtetërore dhe bëhet kur interesi publik mbizotëron kundrejt interesave private, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

"Pronë" nënkupton një send të paluajtshëm, sipas përcaktimit në Kodin Civil.

"Pronar i shpronësuar" nënkupton personin juridik ose fizik apo trashëgimtarët e tyre, prona e të cilëve është shpronësuar nga shteti.

"Parcela" është pasuria e paluajtshme e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

"Punim" është çdo veprim ose proces ndërtimi, gërmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi dhe prerje drurësh.

"Kompensim" nënkupton shpërblimin e drejtë, në momentin e shpronësimit dhe dhënies së shpërblimit, të kryer sipas kushteve të përcaktuara nga Qeveria Shqiptare dhe Banka Botërore.

"Rregullore" është instrumenti, që përmban rregullat e zbatueshme për përdorimin dhe zhvillimin ekzistues e të ardhshëm të tokës.

"Zona" është një pjesë e territorit, me karakteristika ose përdorime të veçanta apo të njëjta, ekzistuese ose të planifikuara të tokës e të strukturave në të, sipas rregulloreve të përdorimit të tokës.

"Zona e Rreptësisë së Mbrojtjes Sanitare" është zona ku do të ndërtohet dhe do të gjendet pusi (burimi i jashtëm i ujit), depot e ujit apo stacionin/stacionet e pompimit, nga e cila mund të priten efektet e drejtpërdrejta mbi banorët dhe familjet dhe e cila kërkon domosdoshmërisht shpronësimin e tokës dhe pasurive të tjera të patundshme.

"Zona e Afërt e Mbrojtjes Sanitare" është zona e dytë e mbrojtjes sanitare që përfshin mbrojtjen e pellgut ujëmbajtës në një distancë 150 m në çdo drejtim nga burimi i jashtëm dhe gjendet në vendbanimet dhe tokat në kontakt me zonën e puseve, e njohur ndryshe edhe si zona e parandalimit të ndotjes.

"Zona e Largët e Mbrojtjes Sanitare" është zona e tretë e mbrojtjes sanitare ku vendoset kontrolli shëndetësor dhe epidemiologjik edhe mbi popullsinë në një rreze prej 1500 m nga burimi i jashtëm i ujit dhe ku zbatohen masa zbutëse/kufizuese për parandalimin e ndotjes së ujit.

"Kufizime të zonave të mbrojtjes" janë ato kushte të cilat specifikojnë se çfarë veprimtarie lejohet të ushtrohet mbi territorin që kërkohet të mbrohet mbi pellgun ujëmbajtës dhe çfarë nuk lejohet.

"Komiteti i Ankimimit" është komiteti i krijuar për pritjen e ankesave nga personat e prekur nga projekti, për kryerjen e procedurave përkatëse për zgjidhja e problemeve, që mund të lindin përgjatë zbatimit të procesit të shpronësimit.

"Ndryshimi i përdorimit të tokës" është përdorimi, që zëvendëson një përdorim të mëparshëm të tokës, fillimi i përdorimit ose rifillimi i tij pas një periudhe të mungesës së përdorimit ose përdorimi i njëjtë apo i ndryshëm.

Neni 4

Parimet e Shpronësimit

Shpronësimi i pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në kuadrin ligjor të mësipërm, duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore. Shpronësimi i pasurisë pronë private bëhet duke respektuar dhe kompensuar në vlerë, në përputhje me ligjin, të drejtat e të tretëve mbi pasuritë pronë private që shpronësohen.

II. Zonat e Mbrojtjes

Neni 5

Përcaktime të zonave të mbrojtjes

Ndërtimi i sistemit të furnizimit me ujë të Durrësit kërkon tri specifika të rëndësishme për qëllime të planifikimit, të vlerësimit dhe mbrojtjes:

- i) Puset duhet të mbrohen nga ndotja e drejtpërdrejtë në afërsi të pusit;
- ii) Uji i pusit duhet të mbrohet nga ndotja mikrobiologjike;
- iii) Uji i pusit duhet të mbrohet nga ndotja kimike.

Këto tri kërkesa janë burim i krijimit të tri zonave në mbështetje të Rregullores Higjeno-Sanitare të miratuar me VKM nr. 145, datë 26.02.1998 si më poshtë:

a) Zona e Rreptësisë së Mbrojtjes Sanitare (S1), e identifikuar me qëllim mbrojtjen e burimit të ujit nga ndotjet e menjëhershme, nga ku priten efektet e drejtpërdrejta mbi banorët dhe familjet dhe e cila kërkon domosdoshmërisht shpronësimin e tokës dhe pasurive të tjera të patundshme. Kjo zonë përfshin puset e ujit, depot e ujit dhe stacionin/stacionet e pompimit. Ajo përfaqëson zonën e cila do të shpronësohet.

b) Zona e Afërt e Mbrojtjes Sanitare (S2) përfshin mbrojtjen e pellgut ujëmbajtës në një distancë 150 m në çdo drejtim nga burimi i jashtëm. Ajo gjendet në vendbanimet dhe tokat në kontakt me zonën e puseve, por jashtë tyre dhe përbën atë që ndryshe quhet zona e parandalimit të ndotjes.

c) Zona e Largët e Mbrojtjes Sanitare (S3) njihet ndryshe edhe si "brezi i mbikëqyrjes epidemiologjike", në të cilën vendoset kontrolli shëndetësor dhe epidemiologjik edhe mbi popullsinë që banon në zonë, e ndikuar nga masat kufizuese/zbutëse për parandalimin e ndotjes së ujit, të cilat duhet të monitorohen me qëllim përdorimin pas ndërtimit të sistemit të ri të furnizimit me ujë. Kjo zonë arrin një rreze prej 1500 m nga burimi i jashtëm i ujit.

Neni 6

Kufizime të lidhura me Zonat e Mbrojtjes

6.1. Kufizime të lidhura me Zonën e Rreptësisë së Mbrojtjes Sanitare (S1)

Zona e Rreptësisë së Mbrojtjes Sanitare do të jetë e rrethuar dhe e pajisur me njoftimet e ndalimit të kalimit dhe do të jetë e mbrojtur nga çdo hyrje e paautorizuar. Në zonë do të ndalohej:

- Çdo aktivitet që nuk lidhet me transportin, mirëmbajtjen dhe akumulimin e ujit të burimit; aktivitetet e magazinimit, ato bujqësore, prodhuese, transporti apo të ndërlidhjeve, kalimi nën tokë apo mbi të i kablove apo tubave që nuk lidhen me aktivitetin e pusit, mbrojtjen e ujit apo monitorimin e tij,
- Çdo lloj ndërtimi që nuk lidhet me ruajtjen e cilësisë dhe sasisë së ujit dhe nxjerrjen, monitorimin e shpërndarjen e tij;
- Hyrja dhe qëndrimi i kafshëve;
- Ndalohet përdorimi i pajisjeve motorike brenda zonës, me përjashtim të gjeneratorëve të energjisë nëse nevojiten.

6.2. Kufizime të lidhura me Zonën e Afërt të Mbrojtjes Sanitare (S2)

Zona e Afërt e Mbrojtjes Sanitare është zona e dytë, menjëherë pas zonës së rreptësisë, e cila arrin një rreze prej 150 m nga burimi i jashtëm i ujit. Në këtë zonë nuk lejohet si më poshtë:

- Aktivitetet bujqësore që nuk janë me baza organike;
- Përdorimi i tokës për aktivitet tregtar, për nxjerrje materialesh, për aktivitet industrial;

- Ekzistenca e varrezave (njerëzore dhe shtazore), proceseve plehëruese, depozitimi i produkteve të naftës, produkteve kimike ose çfarëdo materiali tjetër dekompozues, grumbullimi i ujërave të ndotur në zonë;
- Ndërtimi i godinave të reja, ndërtimi apo ekzistenca e depove të fertilizantëve apo pesticideve të ndryshme;
- Veprimtaritë e saldimeve, minierat e hapura apo të mbyllura;
- Hapja e puseve;
- Hapja e kanaleve të reja (me përjashtim të rasteve kur është e domosdoshme për higjienizimin e zonës dhe largimin e lëndës së ndotur dhe kur kërkohet nga autoritetet e specializuara);
- Depozitimi ose shkarkimi i mbetjeve dhe materialeve të ndotura si bateritë, gomat etj, ujërat e zeza, substanca kimike e toksike.

Çdo iniciative për ndryshimin e përdorimit të tokës, zgjerimin e aktiviteteve ekzistuese, ndryshimin e destinacionit të tyre, aktivitetet e reja të çfarëdolloj natyre, qoftë edhe për qëllime publike etj., mund të kryhet vetëm pas pajisjes me lejen përkatëse nga autoritetet lokale dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit. Përdorimi i pesticideve ose plehrave kimikë në zonë mund të bëhet me lejen, miratimin e institucioneve përkatëse publike dhe për dijeni të Ujësllës-Kanalizime Durrës.

Hapësira do të jetë në monitorim të vazhdueshëm nga institucionet përkatëse; institucionet përgjegjëse do të menaxhojnë në mënyrë të kujdesshme mbetjet e ngurta dhe të lëngëta, do të administrojnë kanalet kulluese dhe ujitëse, infrastrukturën, aktivitetet fitimprurëse etj.

6.3. Kufizime të lidhura me zonën Zonën e Largët të Mbrojtjes Sanitare (S3)

Veprimtaritë e parashikuara për zonën S2, përbëjnë objekt zbatimi edhe zonën S3. Ato mund të kryhen si veprimtari në zonën e tretë të mbrojtjes vetëm kur merret një autorizim i posaçëm administrativ sipas ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore" (i ndryshuar).

III. Detyrimet e Palëve

Neni 7

Detyrimet të përbashkëta të Palëve

Detyrime të përbashkëta të pushtetit vendor (Bashkisë, Ujësllës-Kanalizimeve Durrës dhe Lezhë) dhe agjencive shtetërore zbatuese (autoritetet e mbrojtjes së mjedisit, drejtorive të higjienës, të lumenjve, baseneve etj., ekzistuese dhe të krijuara gjatë zbatimit të projektit dhe pas nënshkrimit të kësaj akt marrëveshjeje) përfshijnë detyrat si më poshtë.

7.1. Detyrime të përgjithshme:

- Të vënë në dijeni individët e prekur nga projekti për mekanizmin e ankimit të quajtur Komiteti i Ankimit, ku ata mund të drejtohen për komunikime, sqarime të mëtejshme dhe për një procedurë të plotë ankimi. Është e detyrueshme që t'u vihen në dispozicion kontaktet e anëtarëve të Komitetit të Ankimit për të lehtësuar komunikimin mes palëve;
- Bashkia, Ujësllës-Kanalizime në bashkëpunim edhe me autoritetet përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes së mjedisit, duhet të ndërmarrin përtej veprimtarisë mbrojtëse edhe veprimtari trajnuese dhe ndërgjegjësuere me fermerët e zonës së puseve.

7.2. Detyrime për zonat e mbrojtjes:

- Të rrethojnë dhe të pajisin zonën S1 me njoftimet e ndalimit të kalimit dhe të ndalojnë hyrjet e paautorizuar;
- Të ndalojnë ushtrimin në zonat S2 të veprimtarive të përcaktuara në nenin 5 të kësaj marrëveshjeje, të hartuar në baze të ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore" (i ndryshuar) dhe Rregullores Higjieno-Sanitare të miratuar me VKM nr. 145, datë 26.02.1998:
 - Aktivitetet bujqësore që nuk janë me baza organike;

- Përdorimin e tokës për aktivitet tregtar, për nxjerrje materiale, për aktivitet industrial;
- Ekzistencën e varrezave (njerëzore dhe shtazore), proceseve plehëruese, depozitimi i produkteve të naftës, produkteve kimike ose çfarëdo materiali tjetër dekompozues, grumbullimi i ujërave të ndotur në zonë;
- Ndërtimin e godinave të reja, ndërtimi apo ekzistenca e depove të fertilizantëve apo pesticideve të ndryshme, veprimtaritë e saldimeve, minierat e hapura apo të mbyllura;
- Hapjen e puseve, hapjen e kanaleve të reja (me përjashtim të rasteve kur është e domosdoshme për higjienizimin e zonës dhe largimin e lëndës së ndotur dhe kur kërkohet nga autoritetet e specializuara);
- Depozitimin ose shkarkimin e mbetjeve dhe materialeve të ndotura si bateritë, gomat etj, ujërat e zeza, substanca kimike e toksike;
- Zgjerimin e aktiviteteve ekzistuese, ndryshimin e destinacionit të tyre, hapjen e aktiviteteve të reja të çfarëdolloj natyre në qoftë se personat fizikë ose juridikë nuk janë të pajisur me autorizimin e posaçëm.
- Të ndalojnë ushtrimin në zonën S3 të veprimtarive të kufizuara në zonën S2, (të cilat sipas ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore" (i ndryshuar) zbatohen edhe mbi zonën e tretë mbrojtëse) nëse nuk është marrë autorizimi i posaçëm sipas ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore" (i ndryshuar).

Neni 8

Detyrime të Veçanta të Palëve

8.1. Detyrimet e Bashkisë janë si më poshtë:

- Të monitorojë mbikëqyrjen e Ujësjiellës-Kanalizimeve në zbatimin e kufizimeve në zonat e mbrojtjes pas fillimit të punimeve dhe të zbatimit të projektit e më tej;
- Të delegojë përfaqësuesin e saj në Komitetin e Ankimimit;
- Të monitorojë punën e Komitetit të Ankimimit dhe ankesat në Komitetin e Ankimimit pas fillimit të punimeve të projektit.

8.2. Detyrimet e Ujësjiellës-Kanalizimeve janë si më poshtë:

- Të vëzhgojë punën e Komitetit të Ankimimit;
- Të delegojë përfaqësuesin e saj në Komitetin e Ankimimit;
- Të mbikëqyrë zbatimin e kufizimeve dhe kërkesave në zonat S1, S2, S3 pas fillimit të punimeve dhe të zbatimit të projektit e më tej;
- Të bashkëpunojë me Autoritetet Vendore (Bashki, Njësi Administrative) në hartimin e një plani trajnimesh dhe një fushate ndërgjegjësuere për personat e prekur nga projekti në kuadër të mirëmbajtjes dhe kufizimeve në zonat e mbrojtjes.

8.3. Detyrimet e Njësisë Zbatuese të Ujit përfshijnë:

- Mbikëqyrjen e zonave S1, S2, S3 deri në momentin e fillimit të punimeve dhe të zbatimit të projektit;
- Realizimin e një inventarizimi të gropave të grumbullimit me ujë të ndotur ose jo, të kanaleve kulluese, të depozitimeve të njohura të mbetjeve etj;
- Përgatitjen e një raporti i cili të përmbajë të dhënat specifike të gropave, kanaleve etj., përpara momentit të fillimit të projektit;
- Mbikëqyrjen e kryerjes së pagesës së dëmshpërblimit përmes Komitetit të Ankimimit;
- Monitorimin e ankesave përmes raportimeve të Komitetit të Ankimimeve deri në momentin e fillimit të punimeve të projektit.

8.4. Detyrimet e Pronarit përfshijnë:

- Të mos shkelë kufizimet e vendosura për zonat e mbrojtjes;

- Të marrë autorizim për çdo hyrje në zonën e mbrojtjes S1;
- Të mos kryejë në tokën në zonën S2 aktivitete si:
 - Aktivitete me bazë joorganike, me përdorim të pesticideve dhe fertilizantëve;
 - Hapje të puseve, të kanaleve, të gropave për depozitim lëndësh ndotëse, kimike apo toksike;
 - Ndërtim i godinave të reja, depove të fertilizantëve, pesticideve apo materialeve dekompozuese;
 - Aktivitete tregtare, industriale, nxjerrje materialesh.
- Për çdo iniciative, e cila përfshin zgjerimin e aktiviteteve ekzistuese, ndryshimin e destinacionit të tyre, aktivitetet e reja të çfarëdolloj natyre në territorin e zonës S2 duhet të merret leje e posaçme pranë autoriteteve vendore dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit
- Të mos zhvillojë në zonën S3 aktivitete saldimesh apo aktivitete minerare.
- Veprimtaritë e ndaluara në zonën S2, mund të kryhen në zonën S3 përmes një autorizimi të posaçëm administrativ, sipas ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore" (i ndryshuar).

IV. Kompensimi i Pronarëve

Neni 9

Kompensimi për Tokën

Shuma e shpërblimit për tokën e shpronësuar përcaktohet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave të datës _____ "Për _____". Z/Znj. _____ do të shpërblehet për sipërfaqen _____, e vlerësuar me çmim ____ duke përfituar gjithsej vlerën prej _____.

Pagesa do të kryhet në një llogari të posaçme në emër të pronarit të shpronësuar, përpara fillimit të punimeve nga kontraktori.

Neni 10

Kompensimi për të Mbjellat dhe Prodhimin

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave mbi shpronësimet, Z/Znj. _____ do të kompensohen për të mbjellat (shitjen/ përdorimin e tyre) në vit duke u bazuar në informacionin e mbledhur dhe në vlerën e tregut për produktet përkatëse.

Shuma e këtij shpërblimi përcaktohet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave të datës _____ "Për _____" është _____. Kjo shumë paguhet njëkohësisht dhe së bashku me kompensimin për tokën e shpronësuar.

V. Dispozita të fundit

Neni 11

Komiteti i Ankimimit

Komiteti i Ankimimit është një komitet i përbërë nga 3 përfaqësues të pushtetit vendor dhe personave të prekur nga projekti (një përfaqësues nga Ujësjetës-Kanalizime Durrës, një përfaqësues nga personat e prekur nga projekti dhe një përfaqësues i Bashkisë _____ gjithashtu kryetar i komitetit). Funkzioni kryesor i këtij komiteti është pritja e ankesave, kryerja e procedurave përkatëse dhe zgjidhja e problemeve, që mund të lindin përgjatë zbatimit të procesit të shpronësimit.

Neni 12

Palët nënshkruese dhe jo nënshkruese të marrëveshjes dhe çdo palë tjetër e interesuar sot dhe në vijim njihet dhe bie dakord me përcaktimet dhe kufizimet e kësaj akt marrëveshjeje.

Neni 13

Kësaj akt marrëveshjeje i bashkëngjitet si pjesë e pandashme:

Aneksi 1. Informacion mbi zonat e mbrojtjes me kufizimet dhe rregullat përkatëse për zbatim në secilën zonë;

Aneksi 2. Dokumentet ligjorë të pronësisë së palës pronare në akt marrëveshje;

Aneks 3. VKM nr. _____ datë _____ "Për _____";

Aneks 4. Skica e dorës e përgatitur për pusin në tokën me pronësi/të drejtë pronësie të Z. _____.

Neni 14

Kjo marrëveshje përgatitet në 4 (katër) kopje në shqip, të cilat kanë të njëjtën përmbajtje dhe fuqi ligjore.

Bashkia _____

Emër Mbiemër i Pronarit _____

Aneks 1: Informacion mbi Zonat e Mbrojtjes

A. Përcaktime lidhur me zonat e mbrojtjes sanitare S1, S2, S3

Ndërtimi i sistemit të furnizimit me ujë të Durrësit kërkon tri specifika të rëndësishme për qëllime të planifikimit, të vlerësimit dhe mbrojtjes:

- i) Puset duhet të mbrohen nga ndotja e drejtpërdrejtë në afërsi të pusit;
- ii) Uji i pusit duhet të mbrohet nga kontaminimi mikrobiologjik;
- iii) Uji i pusit duhet të mbrohet nga ndotja kimike.

Këto tri kërkesa janë burim i krijimit të tri zonave në mbështetje të Rregullores Higjeno-Sanitare të miratuar me VKM nr. 145, datë 26.02.1998 si më poshtë:

a) Zona e Rreptësisë së Mbrojtjes Sanitare (S1), e identifikuar me qëllim mbrojtjen e burimit të ujit nga ndotjet e menjëhershme, nga ku priten efektet e drejtpërdrejta mbi banorët dhe familjet dhe e cila kërkon domosdoshmërisht shpronësimin e tokës dhe pasurive të tjera të patundshme. Kjo zonë përfshin puset e ujit, depot e ujit dhe stacionin/stacionet e pompimit. Ajo përfaqëson zonën e cila do të shpronësohet.

b) Zona e Afërt e Mbrojtjes Sanitare (S2) përfshin mbrojtjen e pellgut ujëmbajtës në një distancë 150 m. Ajo gjendet në vendbanimet dhe tokat në kontakt me zonën e puseve, por jashtë tyre dhe përbën atë që ndryshe quhet zona e parandalimit të ndotjes.

c) Zona e Largët e Mbrojtjes Sanitare (S2) njihet ndryshe edhe si "brezi i mbikëqyrjes epidemiologjike", në të cilën vendoset kontrolli shëndetësor dhe epidemiologjik edhe mbi popullsinë që banon në zonë, e ndikuar nga masat kufizuese/zbutëse për parandalimin e ndotjes së ujit, të cilat duhet të monitorohen me qëllim përdorimin pas ndërtimit të sistemit të ri të furnizimit me ujë.

B.1. Kufizime të lidhura me Zonën e Rreptësisë së Mbrojtjes Sanitare

Në zonën e rreptësisë së mbrojtjes sanitare është i ndaluar çdo ndërtim me përjashtim të atyre në funksion të sistemit të ujit dhe mirëmbajtjes së tij si puset e ujit, mbajtja e ujit dhe stacioni/stacionet e pompimit.

Hyrja në këtë zonë duhet të pengohet me gardhe, të jetë e pajisur me tabela lajmëruese për moslejimin e kalimit dhe të jetë e mbrojtur nga çdo hyrje e paautorizuar. Duhet të ndalohej çdo aktivitet që nuk lidhet me transportin, trajtimin dhe akumulimin e ujit dhe të mirëmbajtjes së sipërfaqes së gjelbër dhe bimësisë ose suporti teknik e zonës së ujit, çdo kablo nëntokësore ose tubacion jo i lidhur me aktivitetin e puseve. Duhet gjithashtu të ndalohen ndërtimet e depove, depozitave të mbetjeve, aplikimi i fertilizantëve dhe pesticideve, hyrja dhe qëndrimi i kafshëve ose përdorimi i pajisjeve motorike. Të vetmet pajisjet motorike të lejuara janë gjeneratorët e energjisë nëse nevojiten. Asnjë kulturë bujqësore nuk lejohet në zonë dhe bari duhet të pritet dhe të hiqet rregullisht nga zona e mbrojtjes. Operatorët e shërbimit të ujit duhet të monitorojnë rregullisht parametrat fiziko-kimike dhe mikrobiologjike në të gjithë zonat e mbrojtjes.

B.2. Kufizime të lidhura me Zonën e Afërt të Mbrojtjes Sanitare

Në këtë zonë aktivitetet e vetme të cilat lejohen janë ato të bazuara në veprimtarinë organike. Sipas legjislacionit shqiptar dhe praktikave ndërkombëtare në zonën e afërt është e ndaluar të ndërtohen godina ose të përdoret toka për aktivitet tregtar, nxjerrës ose aktivitet industrial. Ky territor nuk mund të përdoret për varreza, procese plehërimi, depozita të mbeturinave, produkteve të naftës ose mbeturina kimike ose materiale të tjera dekompozuese. Është e ndaluar ekzistenca e çdo depozite të pesticideve dhe të fertilizantëve kimikë. Përdorimi i pesticideve dhe fertilizantëve në zonë mund të bëhet përmes një autorizimi/leje nga institucionet përgjegjëse dhe për dijeni të përfituesve.

Brenda këtij rripi, ndërtime të mëtejshme nuk do të pranohen. Rindërtim i kanaleve që nuk janë septikë dhe pastrimi i vazhdueshëm i tyre sipas kërkesave të drejtorive të higjienës duhet të bëhet dhe përcaktohet nga autoritetet vendore.

Një menaxhim dhe monitorim i kujdesshëm i mbetjeve dhe ujit, kanaleve kulluese, ujitëse, ndërtimit të strukturave dhe aktiviteteve fitimprurëse duhet të bëhet në koordinim me autoritetet vendore duke përfshirë drejtoritë e higjienës dhe inspektoratet mjedisore. Për rrjedhojë, disa nga masat për t'u marrë janë si më poshtë:

- i. Një inventarizim i gropave të grumbullimit me ujë të ndotur ose jo të shtëpive të banimit, ose të aktiviteteve tregtare duhet të organizohet në fillim të përdorimit; masa të ndërtimit të gropave septike me matjen e parametrave përkatëse;
- ii. Zbrazja, pastrimi dhe higjienizimi i grumbullimit të ujërave sipas kërkesave të autoritetit të shëndetit dhe higjienës,
- iii. Inventarizim i kanaleve kulluese përgjatë territorit në fjalë dhe pastrimi, mirëmbajtja e tyre për të arritur heqjen sa më të mirë të mundshme nga sipërfaqja;
- iv. Çdo iniciativë për zgjerimin e aktiviteteve ekzistuese, ndryshimin e destinacionit të tyre, aktivitetet e reja të çfarëdolloj natyre, qoftë edhe për qëllime publike etj., mund të kryhet vetëm pas pajisjes me lejen përkatëse nga autoritetet lokale dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit.

B.3. Kufizime të lidhura me Zonën e Largët të Mbrojtjes Sanitare

Veprimtaritë e parashikuara për zonën S2, përbëjnë objekt zbatimi edhe zonën S3. Ato mund të kryhen si veprimtari në zonën S3 vetëm kur merret një autorizim i posaçëm administrativ sipas ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore" (i ndryshuar).

Aneks 2: Dokumentacioni i Pronësisë





Aneks 3: VKM Nr _____, Datë _____

Aneks 4: Skica e zonës së puseve



Aneks 3. Harta e Prgjithshme e Zonës së Puseve




Aneks 4 A. Skicat e dorës së Zonës së Puseve¹⁵



¹⁵ Përgatitur nga Inxhinieri Hidro-Gjeolog i Projektit, R. Eftimi.



Aneks 4 B. Stacionet e Pompimit, Fushë Kuqe



LAYOUT OF PUMP STATION BUILDING AND 2 WATER TANKS IN FUSHE KUÇE - DURRES DISTRICT

